

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6766  
E enjte, 24 nëntor 2022  
çmimi 0.40 €

## Kurti: Propozimi franko-gjerman të vendoset në tryezë një orë e më parë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

QEVERIA KURTI KA SHFUQIZUAR TË MËRKURËN VENDIMIN E ISH-QEVERISË HARADINAJ PËR RITJEN E PAGAVE PËR PROKURORË DHE GJYQTARË

## KURTI UA UL PAGAT PROKURORËVE DHE GJYQTARËVE, REAGOJNË OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE



Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të fundit, ka shfuqizuar vendimin e ish-qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave për prokurorët dhe gjyqtarët në vitin 2017. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve kthehen në lartësinë e

rregullimit juridik të mëparshëm para datës së hyrjes në fuqi të vendimit për ngritjen e pagave të kabinetit qeveritar, rrjedhimisht edhe këtyre institucioneve të drejtësisë. Kundër këtij shfuqizimi kanë reaguuar opozita dhe shoqëria civile

### AKTUALE



DHJETËRA TË LËNDUAR NGA TËRMETI NË TURQI

INSTITUTI I PATOLOGJISË PËR 11 MUAJ OFROI MBI 17 MIJË SHËRBIME PËR PACIENTËT

AAK-ja AKUZON QEVERINË KURTI PËR KAPJE TË ADMINISTRATËS SHETËTËRORE

### EKONOMI



DËSHTON INTERVISTIMI I PËRFAQËSUESVE TË KEDS-IT NË KOMISIONIN HETIMOR PËR ENERJINË

EKONOMIA E BRITANISË, MË E GODITURA NË MESIN E G7-S

### SPORT



JAPONIA SHKAKTON BEFASINË E RADHËS NË BOTËTOR, MPOSHTI GJERMANINË

## SITUATA NË VERI HEQ NGA AGJENDA LIBERALIZIMIN E VIZAVE



## QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR PAGA

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Gjykata Supreme vendos kundër referendumit të Skocisë për pavarësi

GLASGOU, 23 NËNTOR - Gjykata Supreme e Mbretërisë së Bashkuar konstatoi të mërkurën se Skocia nuk mund të mbajë referendum të dytë për pavarësi pa lejen e qeverisë britanike.

Ky vendim e kthen një hap prapa fushatën e qeverisë skoceze që synonte të largohej nga Mbretëria e Bashkuar.

Në vitin 2014 skocëzët nuk pranuan t'i jepnin fund bashkimit më shumë se 300-vjeçar me Anglinë, duke votuar 55 për qind kundër pavarësimit nga Mbretëria e Bashkuar në referendumin e mbajtur në atë kohë. Mirëpo aktivistët që kërkojnë pavarësimin, besojnë se referendumi do të kishte rezultate të tjera nëse mbahet sërish tani, dy vjet pas largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian, gjë që skocëzët e kishin kundërshtuar.

Qeveria gjysmautonome e Skocisë dëshironte të mbante referendum në tetor të vitit 2023 me pyetjen "A duhet të jetë Skocia vend i pavarur?"

Ministrja e Parë e Skocisë, Nicola Sturgeon, lidere e Partisë

Kombëtare Skoceze (SNP), që mbështet lëvizjen për pavarësim, kishte bërë me dije më herët këtë vit se referendumi planifikohej për 19 tetor, por se ai duhet të jetë i ligjshëm dhe të njihet ndërkombëtarisht.

Por, Gjykata Supreme konstatoi se nuk është në fuqinë e Parlamentit skocez "të bëjë legjislacion për një referendum për pavarësinë skoceze".

Qeveria konservatore e Mbretërisë së Bashkuar në Londër ka refuzuar ta pranojë një votim të tillë, duke thënë se përgjigja e kësaj pyetjeje ishte dhënë në një referendum të vitit 2014.

Anketat sugjerojnë se skocëzët mbeten të ndarë në gjysmë lidhur me këtë çështje.

Sipas Aktit të Skocisë të vitit 1998, i cili krijoi Parlamentin skocez dhe ia kaloi atij disa kompetenca nga Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar, të gjitha çështjet që lidhen me Unionin e Mbretërive të Skocisë dhe Anglisë i rezervohen Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar.



## Zelensky e quan Rusinë "shtet terrorist" pasi u vra një foshnjë në spital

KIEV, 23 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky të mërkurën e quajti Rusinë "shtet terrorist" që bën "terror vrasje", pasi një foshnjë u vra në një repart të maternitetit pas një sulmi me raketa, në një spital në pjesën jugore të Zaporizhjas. "Edhe një herë armiku vendosi të tentojë ta arrijë përmes terrorit dhe vrasjeve atë që nuk ka qenë në gjendje ta arrijë që nëntë muaj dhe që nuk do të mund ta arrijë", ka shkruar Zelensky në "Facebook" pas sulmit që ndodhi në spitalin e Vilnyansk. "Në vend të kësaj, kjo do të shërbejë vetëm si dëshmi për të gjithë të keqen që i është sjellë vendit tonë", shtoi ai.

Sulmi erdhi përdërisa betejat në rajonet lindore Donetsk dhe Luhansk janë shtuar pas ofensivave nga Rusia. "Gjatë natës përbindëshit rusë qëlluan



me raketa të mëdha në repartin e vogël të maternitetit të spitalit në Vilnyansk. Zemrat i kemi plot

dhimbje - një foshnjë që sapo kishte ardhur në këtë botë u vra", shkroi guvernatori rajonal

Oleksandr Starukh në "Telegram". Shërbimet e urgjencës thanë se ekipet e shpëtimit arritën t'i

shpëtuan dy persona nga rrënojat e repartit të maternitetit. Në fushën e betejës, forcat ukrainase zmbarsën sulme të shumta ruse në Donjeck dhe Luhansk, sipas informatave të dhëna nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës të mërkurën.

Rusia ka nisur një ofensivë përgjatë frontit në përfundim të Donjeckut, duke përdorur disa nga forcat që u tërhoqën nga Hersoni. "Armiku nuk po ndalet së bombarduari pozicionet e trupave tona dhe vendbanimet pranë vijës së frontit (në rajonin e Donjeckut)", ka njoftuar ushtria ukrainase.

Ushtria ukrainase ka theksuar se i zmbarsin sulmet ruse në 11 lokacione në Donjeck dhe Luhansk, duke përfshirë këtu në Bilohoryivka, Bakhmut, Kurdyumivka dhe Severniy.

## Dhjetëra të lënduar nga tërmeti në Turqi

IZMIR, 23 NËNTOR - Të paktën 50 persona janë lënduar nga tërmeti prej 5.9 shkallësh që ka goditur të mërkurën Turqinë.

Tërmeti kishte epiqendër qytetin Golkaya, në provincën Duzce, rreth 200 kilometra në

lindje të Stambollit. Kështu tha Agjencia e Menaxhimit të Fatkeqësive dhe Emergjencave në Turqi. Autoritetet thanë se për shkaqe sigurie është ndërprerë edhe energjia elektrike.

Turqia shtrihet pranë pllakave tektonike dhe goditet rregullisht nga tërmetet. Tërmeti më vdekjeprurës që ka goditur Turqinë vitet e fundit ka qenë ai i vitit 1999, i cili ka lënë të vdekur rreth 17 000 njerëz.





## Ambasadori amerikan në Beograd, Hill: Çështja e targave të shtyhet edhe për një vit

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, ka thënë se çështja e targave ilegale serbe në Kosovë duhet të shtyhet për një vit dhe t'i kushtohet vëmendje zgjidhjes

së çështjeve kyçe. Hill, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve në Beograd, deklaroi se në Kosovë duhet të gjendet zgjidhje afatgjatë dhe se ai territor duhet ta ketë perspektivën e pozicionit

ndërkombëtar.

Siç raporton "Euronews Serbia", Hilli ka thënë se serbët në Kosovë duhet të kenë një perspektivë se si do të jetë jeta e tyre dhe si do ta jetojnë atë. "Ky rajon ka

nevojë që të qetësohen gjakrat", tha Hill. Ai shtoi se situata në Kosovë duhet të qetësohet që edhe atje të krijohen kushtet për ndërtimin e qendrës bioteknologjike dhe zhvillim.



## Kurti: Propozimi franko-gjerman të vendoset në tryezë një orë e më parë



Prishtinë, 23 nëntor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar të mërkurën që plani i Francës dhe Gjermanisë, i përkrahur nga BE-ja, të vendoset në tryezë "një orë e më parë".

Ky plan, sipas raportimeve, është një propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Nuk është koha për ambicje të vogla. Është koha për hapa të mëdhenj", ka thënë Kurti në një konferencë për medie pas mbledhjes së qeverisë.

Ai ka thënë se arsyeja kryesore pse ka shkuar në Bruksel të hënën është nisja e diskutimit për marrëveshjen finale mbi planin franko-gjerman dhe jo

diskutimi për targat. Sipas tij, marrëveshja, ligjërish e obligueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë, ishte pjesë e ftesës së BE-së, por që më pas "u braktis dhe u kalua vetëm te çështjet aktuale".

Kurti ka thënë se Kosova ishte gati që ta pezullonte fazën e dytë të vendimit për targa, e cila parashih shqiptimin e gjobave për qytetarët që qarkullojnë me automjete me targa ilegale serbe në mënyrë që të krijohet hapësirë për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë, "e paraparë nga BE-ja që të arrihej deri në mars të vitit 2023". "Afatin mars 2023 nuk e kam shkruar unë, e ka shkruar

Brukseli. Unë kam kërkuar të jetë shkurti 2023... Por, në fund ata hoqën dorë", ka thënë ai, duke përmendur shefin e diplomacisë evropiane Josep Borrell.

Madje ai tha që në takimin që kishte me Borrellin në Forumin e Paqes në Paris, ai i kishte thënë që propozimi franko-gjerman "është propozim i BE-së, i mbështetur nga Franca dhe Gjermania".

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë se propozimi franko-gjerman parashih zgjidhjen e kontesteve në dy faza, "ku një pjesë e madhe e kontesteve do të zgjidheshin tani, kurse një pjesë shumë e vogël që ata thonë se është 1 për

qind, do të lireshin për një periudhë të mëvonshme".

Në tetor, presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se Franca dhe Gjermania kanë propozuar që Serbia të lejojë që Kosova të anëtarësohet në organizata dhe institucione ndërkombëtare, përfshirë edhe në Kombet e Bashkuara, në këmbim të një anëtarësimi të shpejtë të Serbisë në Bashkimin Evropian.

Kurti konfirmoi se zëvendësi i tij, Besnik Bislimi, është tashmë në Bruksel, ku do të takohet me kryenegociatorin serb Petar Petković për të diskutuar për zgjidhjen e çështjes së targave ilegale serbe.

Takimi në Bruksel do të zhvillohet vetëm dy ditë pas një takimi që ka rezultuar pa marrëveshje mes Kurtit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, lidhur me çështjen e targave. Sipas Kurtit, gjatë gjashtë muajve të fundit kanë qenë tetë opsione për targat, mirëpo nuk dha detaje me arsyetimin se "konfidencialiteti në bisedime është zotim ndaj ndërmjetësit [BE-së]". "Nga këto tetë opsione, për ne tri modele kanë qenë të pranueshme e pesë të papranueshme. Ndërsa për Serbinë asnjë [nga tetë opsionet] nuk ishte i pranueshëm", u shpreh Kurti.

## Kupchan: Gjendja e krijuar në mes të Kosovës dhe Serbisë mbart rrezikun për dhunë

Prishtinë, 23 nëntor - Analisti amerikan Charles Kupchan thotë se gjendja e krijuar në mes të Kosovës dhe Serbisë është e serioze dhe ekziston rreziku për dhunë dhe bllokim të mëtejshëm. Studiuesi i Këshillit amerikan për Marrëdhënie me Jashtë i tha "Zërit të Amerikës" se BE-

ja dhe ShBA-ja kanë të drejtë që janë të shqetësuara, por shtoi se trysnia duhet të mbahet ndaj të dyja palëve. "Situata është mjaft e tensionuar tani, në kuptimin që jemi kemi arritur në një ngërç dhe Qeveria e Kosovës ka rënë dakord për një shtyrje vetëm 48-orëshe dhe

ekziston mundësia që të rikthehemi në një pikë ku ringjallet rreziku për dhunë", tha ai duke iu referuar shtyrjes që Qeveria e Kosovës pranoi për zbatimin e vendosjes së gjobave për targat e makinave në veri pas kërkesës së Shteteve të Bashkuara.







QEVERIA KURTI KA SHFUQIZUAR TË MËRKURËN VENDIMIN E ISH-QEVERISË HARADINAJ PËR RITJEN E PAGAVE PËR PROKURORË DHE GJYQTARË

# Kurti ua ul pagat prokurorëve dhe gjyqtarëve, reagojnë opozita dhe shoqëria civile

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të fundit, ka shfuqizuar vendimin e ish-qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave për prokurorët dhe gjyqtarët në vitin 2017. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve kthehen në lartësinë e rregullimit juridik të mëparshëm para datës së hyrjes në fuqi të vendimit për ngritjen e pagave të kabinetit qeveritar, rrjedhimisht edhe këtyre institucioneve të drejtësisë. Kundër këtij shfuqizimi kanë reaguar opozita dhe shoqëria civile

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 23 NËNTOR** - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën Projektligjin për Paga dhe Projektligjin për Zyrat e Publikë. Në mbledhjen e saj të radhës, qeveria Kurti ka shfuqizuar vendimin e qeverisë Haradinaj të marrë në vitin 2017, duke i kthyer pagat sikur para rritjes në sistemin e drejtësisë.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se vendimi ishte marrë paligjshëm dhe në konflikt-interesi në vitin 2017 nga qeveria e kaluar.

Në vitin 2020 qeveria Kurti kishte ulur pagën e kryeministrit, por jo edhe ato në sistemin e drejtësisë. "Ky vendim ka paraparë përjashtimin nga kthimi i pagave në gjendjen e mëparshme për

sistemin gjyqësor dhe Gjykatën Kushtetuese. Marrë parasysh se ishte në Gjykatën Kushtetuese në procedurë trajtimi, kushti i paraparë për përjashtim është plotësuar me nxjerrjen e aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese lidhur me Ligjin e atëhershëm për Paga, rrjedhimisht për të sjellë ligjshmëri e plotësojmë këtë vendim duke shfuqizuar nenet relevante. Me këtë pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kthehen në lartësinë e rregullimit juridik të mëparshëm", ka thënë Kurti.

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka reaguar pas shfuqizimit të vendimit nga ana e Qeverisë së Kosovës, i cili ua kthen pagat gjyqtarëve dhe prokurorëve ashtu siç i kishin para se t'i merrnin me rritje.

Haradinaj ka thënë se me këtë vendim kryeministri Kurti i ka goditur prokurorët dhe gjykatësit. "Albin Kurti ka marrë mision shkatërrimin e shtetit. Pas shkakimit të rrezikut në veri, ngecjes në dialog dhe prishjes me amerikanët, sot ka vendosur ta shkatërrojë sistemin e drejtësisë. Me vendimin e qeverisë që të shfuqizohet vendimi im për rritjen e pagave për gjyqtarë dhe prokurorë, nga sot drejtësia do të punojë me paga të përgjysmuara. Prokurorët dhe gjyqtarët që çdo ditë mbrojnë shtetin dhe drejtësinë, sot janë goditur nga kryeministri i shkatërrimit. Ftoj Kurtin që menjëherë t'i kthejë pagat e prokurorëve dhe gjyqtarëve në nivelin që kanë qenë sepse, përndryshe, mund të shkatërrohet nga brenda njëri prej segmenteve më të rëndësishëm të një shteti, drejtësia. Nëse nuk ndalesh pasojat do të jenë të pariparueshme!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ndërkaq drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka thënë se një jurist me njohuri elementare e di se vendimi i qeverisë për uljen e pagave për gjykatës dhe prokurorë është i

kundërligjshëm. "Një jurist me njohuri elementare e di se vendimi i qeverisë për uljen e pagave për gjykatës dhe prokurorë është i kundërligjshëm. Ky vendim nuk ka për të gjetur zbatim. Nuk mund të zbatohet një vendim i kundërligjshëm. Më vjen keq për kryeministrin Kurti për nivelin e njerëzve që e këshillojnë në çështje të drejtësisë. Këta nuk ia duan të mirën kryeministrit. Të njëjtët nuk duhet ta vënë në situata të tilla kryeministrin", ka theksuar Miftaraj.

E analisti politik Agon Maliqi ka shprehur shqetësimin se pse tash po ulen pagat në sistemin e drejtësisë. "Cili është synimi i uljes së rrogave në sistemin e drejtësisë, i shkëputjes së kontratës kolektive të MASHTI-t, i marrjes së mjeteve prej buxhetit të Prishtinës. Të gjitha në pikun e krizës me veriun? Kjo diqysh si me dashtë me qëllim për t'i shkaktuar vetes jostabilitet politik dhe për ta provokuar opozitën në zgjedhje të parakohshme. Tybe s'po më duket se e ka plan me e prek kush. Rimë kryeministër, grahi... ti po di", ka shkruar Maliqi në "Facebook".

Ndaj vendimit për uljen e pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve

kanë reaguar edhe organizatat e shoqërisë civile. Sipas shoqërisë civile, ky vendim i qeverisë Kurti është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. "Përkundër faktit se shoqëria civile vazhdimisht ka theksuar se vendimi për ngritje të pagave ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, kushtetutshmëria e këtij vendimi është konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese. Ky vendim nuk është shfuqizuar nga asnjë institucion tjetër derisa nuk është konfirmuar as përgjegjësia penale për nxjerrjen e këtij vendimi. I njëjti, po ashtu, është reflektuar edhe në vendimin e qeverisë të datës 12 shkurt 2020. Sa i përket vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese përkitazi me Ligjin nr.06/L-111 për pagat në sektorin publik, Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka nxjerrë vendim për shfuqizimin e këtij ligji. Kështu, çështja e pagave nuk është rregulluar me këtë ligj. Tutje, që nga koha e publikimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me këtë ligj e deri më sot, kanë kaluar mbi dy (2) vjet e katër (4) muaj. Në këtë mënyrë, përtej pretendimeve, ngritja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve tanimë është konfirmuar në



# Mavraj i quan debakël politikat e qeverisë për temat aktuale

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Publicisti Muhamet Mavraj i ka komentuar zhvillimet e fundit në Kosovë në llogarinë e vet në "Facebook". Ai i ka quajtur debakël politikat e qeverisë Kurti për temat aktuale. Mavraj edhe një herë ka përsëritur se kjo qeveri nuk duhet të japë dorëheqje dhe as nuk duhet të shkarkohet. "Pavarësisht prej debaklit të stanit, debakleve të shkuara e të ardhshme, pavarësisht se po luhet lojë e mullinjve të huaj, edhe një kohë: Jo dorëheqje! Jo shkarkime! Pa u ngi mirë, jo! Pastaj dihet...", ka shkruar Mavraj.



## Postimi i plotë i Mavrajt:

"Ndonjëherë njerëzit nuk duan ta dëgjojnë të vërtetën, sepse nuk duan që t'u shkatërrohen iluzionet e tyre" (Nietzsche). Pavarësisht prej debaklit të stanit,

debakleve të shkuara e të ardhshme, pavarësisht se po luhet lojë e mullinjve të huaj, edhe një kohë: Jo dorëheqje! Jo shkarkime! Pa u ngi mirë, jo! Pastaj dihet...



## Situata në veri heq nga agjenda liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Propozimi për liberalizimin e vizave për Kosovën, i cili parasheh lëvizjen e lirë jo më larg se data 1 janar e vitit 2024, u hoq nga agjenda e takimit të sotëm të ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së. Arsye për këtë janë politike dhe lidhen me situatën në veri të Kosovës. "Për shkak të zhvillimeve politike në veri të Kosovës, ta kemi këtë pikë në agjendën e Coreper-it [trupi i ambasadorëve] nuk është ideale", tha Presidenca Çeke e BE-së në njoftimin për shtyrje. Sipas saj, diskutimi për këtë çështje do të mbahet më 30 nëntor. "Bëjmë thirrje për shtensionim të menjëhershëm të situatës aktuale në Kosovë në lidhje me targa e makinave", tha Eva Hrnčirova, zëdhënëse e trupit të ambasadorëve, Coreper. Situata në veri të Kosovës është tensionuar për shkak të vendimit të qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti për ta nisur procesin e reregjistrimit të

makinave që bartin targa ilegale serbe. Serbët në veri, të kontrolluar në masë të madhe nga Beogradi zyrtar, i kundërshtojnë targa e Kosovës, RKS, dhe kanë paralajmëruar rezistencë ndaj tyre. Me gjithë thirrjet e komunitetit ndërkombëtar për shtyrje të procesit të reregjistrimit, Kurti nuk ka hequr dorë. Aktualisht është e pezulluar - deri më 24 nëntor - faza e dytë e planit të tij, në përpjekje për t'i dhënë shans gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme për të dyja palët.

### Çfarë ndodhi më 22 nëntor në Bruksel?

Të martën e 22 nëntorit këshilltarët për viza në Këshillin e BE-së u pajtuan me propozimin që liberalizimi i vizave për Kosovën të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2024. Kjo datë ishte kërkesë e Spanjës - njërit prej pesë vendeve të BE-së që

nuk e njeh ende pavarësinë e Kosovës - pasi Presidenca Çeke e BE-së kishte propozuar fillimisht datën 1 dhjetor 2023. Sipas propozimit të ri, "hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës do të nisë në kohën kur të jetë funksional sistemi i udhëtimit ETIAS, por jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024".

Miratimi i këtij propozimi pritej të dilte në rend dite në takimin e sotëm të ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së për të vazhduar më pas nëpër instanca të tjera.

Liberalizimi i vizave do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen e që përbëhet prej 26 shtetesh evropiane.

Aktualisht Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në këtë zonë pavarësisht prej faktit se Komisioni Evropian, qysh në



vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezerva.

### Ku buron lidhja me sistemin ETIAS?

Në një takim të grupit punues për viza të Këshillit të BE-së, të mbajtur më 13 tetor, zyrtarët francezë

propozuan që liberalizimi i vizave për Kosovën të lidhet me funksionalizimin e të ashtuquajturit sistem ETIAS. Ky sistem digjital synon ta bëjë evidentimin e vizitorëve që hyjnë prej jashtë BE-së në zonën e lëvizjes së lirë, Schengen. ETIAS është dashur të nisë së funksionuar në vitin 2022, por data është shtyrë disa herë dhe tani si afat përmendet nëntori i vitit 2023.

rrugë institucionale. Kështu, përtej kualifikimit formal, vendimi i sotëm i qeverisë paraqet ulje të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve", është thënë në reagimin e shoqërisë civile.

Më tutje, shoqëria civile ka vlerësuar se vendimi i qeverisë për uljen e pagave për prokurorët dhe gjyqtarët paraqet ndërhyrje në sistemin e

drejtësisë.

"Komisioni i Venecias ka përcaktuar standardet se ulja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk është e lejuar, përjashtimisht rasteve shumë specifike të cilat nuk paraqiten në situatën konkrete. Në shkurt të vitit 2020, kur në procedurë në Gjykatën Kushtetuese ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Paga, gjykata ishte

drejtuar Komisionit të Venecias me një pyetje dhe disa nënpyetje thelbësore në lidhje me çështjen e uljes së pagës për pushtetin gjyqësor. Përgjigjet e Komisionit të Venecias ishin se 'ulja e pagave të gjyqësorit mund të ndodhë vetëm nën kushte të një krize të theksuar ekonomike dhe financiare dhe e cila për më tepër duhet të jetë e njohur zyrtarisht si e tillë' dhe se 'pavarësia gjyqësore

kërkon një shkallë themelore të sigurisë financiare nga ndërhyrjet arbitrare nga ekzekutivi ose degët e tjera të pushtetit'. Për këto arsye, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve paraqet qartazi ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit dhe është në kundërshtim me standardet e ndërtuara nga Komisioni i Venecias. Për më tepër, sa ishte në

opozitë, vetë Lëvizja Vetëvendosje në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese kishte theksuar se '...ulja dhe rritja e tyre (pagave) është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës...', është thënë në këtë reagim të shoqërisë civile, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës që me urgjencë ta anulojë vendimin për uljen e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët.



## Situata e sigurisë në Skenderaj, e qetë

SKENDERAJ, 23 NËNTOR - Komiteti për Komunitete i komunës së Skenderajt ka mbajtur takimin e radhës në të cilin anëtarët e tij kanë diskutuar për pikat e rendit të ditës. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil

Nura, i cili ka diskutuar për punët dhe angazhimet e komunës sa iu përket investimeve publike në fshatrat ku jetojnë komunitet joshumicë. Ai ka thënë se komuna ka investuar në infrastrukturën rrugore, në sistemin e trajtimit të ujërave

të zeza dhe në projektin e ndriçimit publik në këto pjesë, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve. Sa i përket situatës së sigurisë, nga ana e përfaqësuesit të Policisë së Kosovës ajo është cilësuar e qetë.



# Arrestohen tre të dyshuar për 'fajde', 'kanosje' dhe 'detyrim'

PRIZREN, 23 NËNTOR - Pas një pune intensive operative-hetimore, zyrtarët policorë të Sektorit të Hetimeve Rajonale të Prizrenit, me mbështetje edhe të njësive të tjera policore, më 21 nëntor, rreth orës 18:30, kanë lokalizuar vendqëndrimin e tyre dhe kanë arrestuar të dyshuarit A. H. (43 vjeç), A. R. (34 vjeç) dhe E. M. (37 vjeç) për shkak të

ekzistimit të dyshimit të arsyeshëm për kryerje të veprave penale "fajde", "kanosje" dhe "detyrim". Arrestimi i të dyshuarave është bërë pas aplikimit të masave të fshehta teknike të përgjimit dhe të vëzhgimit. Me urdhër verbal të prokurorit të Shtetit dhe në prani të avokatit mbrojtës është kryer edhe kontroll në

objektet e banimit të personave të dyshuar me ç'rast janë sekuestruar dëshmi, dokumente relevante që mbështesin dyshimet për përfshirjen e tyre në kryerje të këtyre veprave penale. Me aktvendimin me shkrim të prokurorit të Shtetit tre të dyshuarave u është shqiptuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh.



## Komuna e Prizrenit dhe Fondacioni "Jahjaga" nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRIZREN, 23 NËNTOR - Komuna e Prizrenit dhe Fondacioni "Jahjaga" kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e mekanizmave për ofrimin e mundësive dhe hapësirave për realizimin e fazës së mentorimit/praktikës në bashkëpunim me drejtoreshat komunale. Gjatë një muaji dy vajza do ta kenë mundësinë të punojnë dhe mësojnë nga dy drejtoresha të komunës së Prizrenit. Komuna e Prizrenit ka njoftuar se

ndër prioritetet e veta ka fuqizimin e pozitës së gruas në shoqëri në të gjithë sektorët. Ndërkaq, Fondacioni "Jahjaga", përmes programit të grave në politikë, në vazhdimësi kontribuon për promovimin dhe fuqizimin e rolit të gruas në këtë fushë. Në këtë program, gjithashtu, fokus i veçantë i kushtohet rinisë, me theks inkurajimit dhe fuqizimit të vajzave të reja të cilat kanë aspirata të zhvillimit të karrierës në politikë.

## Komuna e Gjilanit, fituese e Çmimit Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer

GJILAN, 23 NËNTOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pranuar Çmimin Evropian për Qeverisje të Shkëlqyer nga Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale - ALDA. "Komuna e Gjilanit ka përfunduar me sukses procesin e Çmimit Evropian të Qeverisjes së Shkëlqyer (ELOGE) dhe ka arritur një nivel të lartë të qeverisjes, të

krahasuar me 12 parimet e Këshillit të Evropës në kuadër të Qeverisjes së Mirë Demokratike", ka thënë Hyseni, duke shtuar se do të vazhdojnë të angazhohen për përmirësimin e performancës komunale dhe ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë. "Për një qeverisje të drejtë dhe transparente", është shprehur ai.



## Instituti i Patologjisë për 11 muaj ofroi mbi 17 mijë shërbime për pacientët

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Në Institutin e Patologjisë, i cili punon në kuadër të Instituteve Paraklinike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nga

data 1 janar deri më 22 nëntor janë ofruar 17 125 shërbime për pacientët. Gjatë kësaj kohe në këtë institut janë analizuar 10 840

mostra biotike dhe 1 300 mostra citologjike. Për 11 muaj janë punuar 2 511 papteste nga Klinika e Gjinekologjisë dhe 1 584 papteste të

screening, 33 analiza me ngjyrim histokimie, 842 analiza me ngjyrim imunohistokimike dhe janë kryer dy raste të autopsisë.





## Këshilli Prokurorial dhe Dogana nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Dogana e Kosovës (DK) kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi.

Ky memorandum i bashkëpunimit është nënshkruar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku dhe drejtori i Doganës, Agron Llugaliu. Qëllimi i këtij memorandum

është ndërlidhja e sistemeve elektronike dhe shkëmbimi i të dhënave në formë elektronike në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Doganës.

Të gjitha të dhënat nga Dogana e Kosovës në prokurori do të dërgohen në formë elektronike nga sistemet e tyre për menaxhimin e lëndëve dhe anasjelltas.

Pas nënshkrimit të këtij

memorandumi, kryesuesi i KPK-së dhe drejtori i Doganës së Kosovës vlerësuan lart bashkëpunimin e deritashëm të dy institucioneve përkatëse, duke thënë se ky memorandum i nënshkruar vërteton gatishmërinë e përbashkët për thellimin e bashkëpunimit, me qëllimin e vetëm fuqizimin e luftës kundër dukurive kundërligjore.



# AAK-ja akuzon qeverinë Kurti për kapje të administratës shtetërore

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, i shoqëruar edhe nga bashkëpartiakët Diellza Kukaj dhe Nazim Gagica, kanë shprehur shqetësimin e kësaj partie për veprimet e qeverisë ndaj administratës shtetërore. "Qeveria e Kosovës, në emër të reformës, e ka deformuar në esencë administratën shtetërore me miratimin e dy ligjeve që e kthen Kosovën në kohën e UNMIK-ut. Nuk ka vend as në Evropë e as në Ballkanin Perëndimor i cili mundohet që me ligj ta kapë administratën shtetërore, ku përmes Ligjit për Zyrtarët Publikë, 1 600 pozita të shërbimit publik në karrierë i kthen në pozita me mandat politik katërvjeçar. Me këtë e bënë një goditje të madhe ndaj shtetit të Kosovës, administratës dhe meritokracisë", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se raporti i BE-së, i cili është dorëzuar më 7 tetor të këtij viti, e kundërshton fuqishëm këtë ligj. "Po ashtu, mendimi ligjor i organizatës SIGMA, që është dorëzuar në gusht të vitit 2022, e kundërshton fuqishëm Ligjin për Zyrtarët e Lartë Publikë. Ligji për Zyrtarët e Lartë Publikë dhe Ligji i Pagave e vrasin shpresën e secilit zyrtar shtetëror, për një karrierë të mirëfilltë profesionale dhe për një pagë të dinjitetshme. Nuk ka vend në kontinent, i cili në këtë krizë



ekonomike dhe pas pandemisë i zvogëlon pagat. Sot gjyqtarët, prokurorët e një numër i madh i zyrtarëve publikë janë në ethe dhe të pashpresë nga dy ligje që, në fakt, janë sëmundja dhe virusi që i kanë hyrë administratës shtetërore

tash e 20 vjet", ka thënë ai. Sipas Tahirit, kjo qasje e bën edhe më problematike situatën, duke e ditur se ku jemi si vend dhe si administratë shtetërore. "FMN-ja ka pasur kërkesë të drejtpërdrejtë nga qeveria për rritje të pagës,

institucion ky që zakonisht është kundër rritjes së pagave. Pra, nuk ka asnjë reflektim. Qëllimi është që të deformohet sistemi në administratë, të bëhet kapja e shtetit me ligj, të stimulohen nepotizmi, klientelizmi politik edhe

korupsioni. Që 20 muaj i ka mbajtur peng të punësuarit në sektorin publik duke folur për Ligjin e Pagave dhe, në fund, i kalon dy ligje që e vrasin shpresën e secilit zyrtar në administratën publike", ka deklaruar Tahiri.

## "Rahoveci digjital", edhe një premtim i realizuar nga Smajl Latifi

RAHOVEC, 23 NËNTOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka përmbushur edhe një zotim publik, lansimin e projektit "Harta turistike e Rahovecit dhe harta e trashëgimisë kulturore me QR code "Rahoveci digjital", i cili është projekti i radhës i zhvilluar nga komuna e Rahovecit.

Kryetari Latifi ka thënë se ky projekt është i nevojshëm për orientimin e vizitorëve të huaj në Rahovec dhe mundësi promovimi i potencialit turistik të kësaj komune, të trashëgimisë

kulturore dhe historike dhe vlerave të tjera, si dhe një hap i rëndësishëm për planifikimet e ardhshme në këta lëmenj.

Në hartë janë të paraqitur informacioni kryesor i atraksioneve turistike në komunën e Rahovecit për t'u vizituar si dhe QR code (barkod), janë të përfshira 108 objekte të propozuara nga komuna e Rahovecit të ndara në atraksionet turistike, monumentet e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore me 46 objekte, akomodim dhe gastronomi me

31 objekte, veraritë dhe bodrumet me 17 objekte dhe dyqanet dhe pikat e tjera me 14 objekte.

Latifi ka theksuar se harta është realizuar me programe bashkëkohore digjitale dhe hartografike, ku për këtë ka falënderuar "SHL KOSOVA", dy drejtoritë bartëse të këtij projekti DEZHT dhe DKRS, ekspertin Idriz Shala, zyrtarët nga zyra e IT-së, Rama Print, si dhe të gjithë ata që i dhanë shtysë kësaj nisme dhe kontribuan në realizimin e këtij projekti.





## Ekonomia e Britanisë, më e goditura në mesin e G7-s

LONDËR, 23 NËNTOR - Kriza globale e energjisë do ta godasë ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar më shumë sesa ato të shteteve të tjera të fuqishme në botë, ka thënë Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Sipas raportit të saj më të ri, në krahasim me vendet e tjera që përbëjnë grupin e shtatë shteteve më të industrializuara (G7), ekonomia britanike do të jetë më e goditura. Përveç Britanisë, në G7 bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Franca, Gjermania,

Italia dhe Japonia. Rritja ekonomike në Shtetet e Bashkuara dhe Eurozonë do të jetë e zbehtë, mirëpo Gjermania është shteti tjetër i fuqishëm të cilit pritet t'i tkurret ekonomia. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim ka parashikuar "ngadalësim të konsiderueshëm të rritjes ekonomike" në gjithë botën më 2023. Sipas saj, rritja në nivel global pritet të jetë 2.2 për qind. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, trup ndërkombëtar që fokusohet në politikat ekonomike, ka

vlërësuar se skema britanike për mbështetje të qytetarëve për t'i paguar faturat e energjisë është faktore për një situatë të tillë ekonomike. Sipas saj, ndonëse ndarja e subvencioneve zvogëlon rritjen e menjëhershme të inflacionit, megjithatë presioni për një rritje të tillë bartet në periudhë afatmesme. Rritja e kërkesës për produkte dhe shërbime të tjera, pas heqjes së masave kufizuese për luftim të pandemisë së koronavirusit dhe lufta e Rusisë në Ukrainë, besohet se janë dy shkaqet kyçe që kanë



ndikuar në rritje të inflacionit në shumë vende të botës. Disa organizata botërore kanë paralajmëruar se bota mund të përballet me recesion global

më 2023. Recesioni përshkruhet si tkurrje e ciklit të bizneset dhe, për pasojë, ka rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik.

## Qeveria miraton Projektligjin për Paga



PRISHTINË, 23 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën Projektligjin për Paga, që sipas ekzekutivit, krijon sistem të unifikuar të pagave për të gjithë personat që paguhen nga buxheti i shtetit. "Ne jemi siguruar që të zvogëlohet dukshëm dallimi në mes pagës më të lartë dhe asaj më ulët, nga 20 herë sa është sot, në 4.78 herë midis kreut të shtetit dhe zyrtarit më thjesht në hierarkinë shtetërore", ka thënë kryeministri i Kosovës, Albin

Kurti, në mbledhjen e qeverisë. Pas miratimit në qeveri, projektligji duhet të miratohet edhe në Kuvendin e Kosovës dhe hyn në fuqi tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

### Çka parasheh Projektligji i Pagave?

Pagat e punëtorëve në Kosovë llogariten duke e shumëzuar koeficientin e pagës së një pozite me vlerën monetare të

koeficientit. Në total janë 18 koeficiente. Në projektligjin e miratuar më 23 nëntor nuk përcaktohet vlera monetare e koeficientit, por thuhet se "vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit". Raporti i koeficienteve është 1:18. Kuvendi i Kosovës në fund të muajit të kaluar ka miratuar Ligjin për Buxhetin, por nuk është përcaktuar ndonjë vlerë monetare e koeficientit. Partitë opozitare, Partia

Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, mospërfshirjen e koeficientit në buxhetin e vitit 2023 e kanë konsideruar "mashttrim".

### Koeficientet

Koeficienti më i lartë, 18, sipas projektligjit, i takon vetëm presidentit të Kosovës. Niveli i koeficientit 17.5 i takon kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Koeficienti 17 i takon kryetarit të Kuvendit të Kosovës si dhe kryeministrit. Për mjekët specialistë, koeficienti është 12. Mësimdhënësit në shkolla fillore dhe ato të mesme të ulëta do ta kenë koeficientin 5.6 Në fund të gushtit të këtij viti mësimdhënësit dhe shërbyesit civilë kanë mbajtur grevë në kërkim të miratimit të këtij projektligji. Për pasojë, procesi mësimor ka nisur me një muaj vonesë.

## Dështon intervistimi i përfaqësuesve të KEDS-it në Komisionin Hetimor për energjinë

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Në Komisionin Hetimor për energji ka dështuar intervistimi i dëshmitarëve për Kompaninë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike (KEDS) dhe Kompaninë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO). Kryetari i komisionit në

lidhje me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike, Hajdar Beqa, ka theksuar se dëshmitarët e KEDS-it dhe KESCO-s kanë dhënë një arsytim tek administrata se

nuk do të mund të jenë të pranishëm të mërkurën në komision. Beqa ka thënë se pa dëshminë e tyre nuk mund të ketë një raport të plotë hetimor dhe shtoi se do t'i shikojnë mundësitë që intervistimi i tyre të ndodhë para përfundimit të mandatit të komisionit.





# Fronti Perëndimor në kërkim të heronjve të gabuar



Nga Angelo PANEBIANCO

Lufta nuk ka mbaruar ende, dhe kundërpërgjigja mund të jetë e tmerrshme. Por në këtë moment, siç e tregoi tërheqja e rusëve nga Kerson, Davidi po e mposht Golian. Kjo falëgatishmërisë së ukrainasve për të mbrojtur veten por edhe mbështetjes perëndimore.

Një mbështetje që jo pak njerëz në Perëndim do të donin ta ndalonin. Edhe kjo luftë, ashtu si shumë ngjarje të tjera, dëshmon se shoqëritë perëndimore ndodhen aktualisht në një gjendje paradoksale. Nga njëra anë, e maksimalizojnë rëndësinë dhe dinjitetin e njerëzve, duke idhënë atyre një gamë të gjerë të drejtash individuale.

Nga ana tjetër, janë shoqëri në të cilat përpunohen dhe shpërndahen gjerësisht konceptet e jetës shoqërore dhe të historisë njerëzore, të cilat i zhvlerësojnë individët, njerëzit prej mishi dhe gjaku. Kjo me pasojë mohimin apo harresën e vetë arsyeve që e bëjnë të mundur ekzistencën e atyre të drejtave individuale këtu tek ne. Në versionet më të sofistikuar, janë konceptet për të cilat kanë rëndësi vetëm "strukturat" – sociale, ekonomike etj që i japin formë individëve, dhe që i zbrazin këta të fundit nga çdo vullnet i tyre. Në versionet më të vrazhda, këta individë janë kukulla të stërvitura në duart e

"fuqive shumë të forta" (fuqitë e mëdha, NATO, shumëkombëset, kapitali financiar etj).

Por kujdes, nuk kemi të bëjmë me koncepte që mbeten të mbyllura në rrethe të kufizuara intelektuale. Jo, ato vërshojnë në komunikimin publik, depërtojnë kudo. Shumica e atyre qëmendojnë se në luftën që po zhvillohet në Ukrainë, e vetmja gjë që ka vërtet rëndësi është shmangia e luftës midis NATO-s dhe Putinit, i konsiderojnë si të parëndësishme idetë dhe vullnetet e njerëzve të zakonshëm.

Natyrisht, mospërputhja e këtyre qëndrimeve dëshmohej nga fakti se mbështetësit e tyre nuk do të ëndërronin kurrë të mendonin për veten në terma të tillë: për ta kukullat janë vetëm të tjerët. Këto koncepte kanë ndikuar shumë mbi mënyrën se si një pjesë e Evropës, një pakicë, por jo e parëndësishme, dhe gjithsesi shumë e dukshme dhe e zëshme, ka qenë e pranishme në komunikimin publik që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës, dhe ndoshta do të ketë dhe më shumë peshë në fazën tjetër të konfliktit.

Armët e vendeve perëndimore, do të kishin qenë të kota në rast se ukrainasit, njerëzit e zakonshëm, nuk do të kishin vendosur të rezistonin, të mbronin veten, të dashurit e tyre, lirinë, vendin e tyre. Ata gjetën – siç ndodh për fat në

histori – një udhëheqës (dhe njerëzit e tij) në lartësinë e kësaj sfide.

Por Zelenski nuk mund të kishte bërë asgjë nëse ukrainasit nuk do të kishin zgjedhur t'i bashkoheshin atij në një rezistencë, e cila në fillim dukej e dëshpëruar, dhe pa asnjë shans për fitore. Një vullnet për të rezistuar, që iu kundërvu mungesës së motivimit të ushtarëve rusë, të cilëve u duk e pakuptueshme pse ishin atje për të vrrarë e për të vdekur.

Ashtu si në kohën e ndërhyrjes amerikane në Vietnam apo pushtimit rus të Afganistanit, ajo që bën dallimin real nuk është ndihma e jashtme – e cila ka qenë gjithmonë atje – por forca ose dobësia e motiveve dhe e bindjeve të luftëtarëve (nga njëra anë dhe tjetra), si dhe grupet njerëzore të përfshira.

Kjo shpjegon edhe arsyen pse ndonjëherë Davidi është në gjendje të mposhtë Golian. Megjithatë, ky nuk është një reflektim vetëm për të kaluarën. Por edhe të tashmen dhe të ardhmen. Shumë shpejt zërat e atyre në Evropë që do ta akuzojnë Zelenskin si lakmitar dhe arrogant, që dëshiron shumë (rikthim në kufijtë para pushtimit të Krimesë), do të bëhen gjithnjë e më këmbëngulës.

Është e qartë se komuniteti ndërkombëtar, duhet të bëjë gjithçka që është e mundur për të parandaluar që lufta në

Ukrainë të rikthehet në një luftë botërore. Një rrezik që buron ngafakti se autokratët nuk mund të pranojnë lehtësisht humbjet në luftë.

Herët a vonë ata do ta humbnin pushtetin, dhe në atë lloj regjimi, kjo nënkupton edhe humbjen e jetës. Të njëjtin fat do të kishin edhe besnikët e autokratit. Por është po aq e dukshme, ose duhet të jetë, se Zelenski nuk është vetëm. Ai duhet të japë llogari para një populli që ka kaluar nëpër një provë të tmerrshme, dhe vuajtjet e të cilit nuk mund të fshihen me një të rënë të lapsit.

Urrejtja për pushtuesin nuk do të shuhet. Ashtu si ai i kujt do tjetër që do të kishte përjetuar një histori të ngjashme. Edhe sikur të ishte pacifisti më i thekur. Nëse negociatat do tëëndodhin ndonjëherë, ato do të synojnë të gjejnë një ekuilibri të vështirë midis nevojës për të garantuar paqen në Evropë, dhe asaj për të mos mohuar të drejtat e një populli të sulmuar në mënyrë brutale.

Një efekt anësor i kësaj lufte – nëse në fund Rusia do të mposhtet – do të jetë me siguri fundi i simpatisë së përhapur që gëzon Putin në Evropë, "burri i fortë", ai që është i aftë t'u bëjë ballë amerikanëve. Dështimi e shkatërron popullaritetin.

Natyrisht, pavarësisht nëse Putini do të mbetet apo jo në pushtet, përderisa Rusia nuk ka gjasa të bëhet një demokraci,

kërcënimi i saj për Perëndimin, dhe veçanërisht për Evropën, nuk do të zbehet. Por të paktën, "heroi" kryesor dhe kampioni i sjelljeve anti-perëndimore në sytë e vetë anti-perëndimoreve tanë do të humbasë tërheqjen ndaj tij.

Sigurisht, herët a vonë, në vend të tij do të identifikohen heronj të rinj. Udhëheqësit kinezë? Sigurisht që nga Kina do të vijë një sfidë shumë e rrezikshme dhe tinëzare për shoqëritë perëndimore. Por nuk ka gjasa që Xi Jinping të ketë të njëjtin popullaritet në Evropë si Putin. Pasi hendeuku kulturor është shumë i madh. Megjithatë, le të rrinë të qetë armiqtë tanë të Perëndimit. Atyre nuk do t'u mungojnë heronjtë. Herët a vonë, do të dalë nga diku një tjetër kampion i ri i anti-perëndimorizimit. Edhe ai tenton të tregojë se ne të gjithë jemi kukulla (përveç atij dhe atyre që besojnë në kauzën e tij) në mëshirën e forcave djallëzore. Mbase më vonë, një sipërmarrës do të shfrytëzojë rastin, dhe siç ndodhi me Çe Gevarën, do të fillojë të prodhojë bluza me figurën e heroit. Disa nga ata që do i veshin, do të mendojnë se po bëjnë një gjest rebelimi kundër shoqërisë së hapur perëndimore. Në vend të kësaj, ata do të kontribuojnë për të rinovuar lavdinë e saj.

"Corriere Della Sera" – Bota.al



# Ushtria Çlirimtare e Kosovës në tri kohë



**Bedri ZYBERAJ**

## Hyrje

Sot pothuajse për secilin që ka një rezon minimal të analizës dhe gjykimit racional për proceset historike të zhvillimit të Kosovës, dëshmitarë të së cilës kohës jemi pothuaj çdonjëri prej nesh këtu, është bërë krejtësisht e qartë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) ishte një realitet i domosdoshëm ushtarak dhe politik e cila tanimë është deponuar si e tillë në thesarin e historisë sonë më të re. Kjo ushtri është themeluar në një kohë mjaft të vështirë dhe, për disa vjet rresht, derisa nuk filloi lufta e hapur, ka qenë e detyruar që të veprojë në rrethana jashtëzakonisht të vështira dhe të mundimshme. Në rrethana, po ashtu të vështira dhe të mundimshme, ka qenë e detyruar ta zhvillojë edhe luftën, pas përfundimit të së cilës, për shkak të trysnisë politike, brenda një kohe shumë të shkurtër, saktësisht më 19 shtator të vitit 1999, detyrohet të transformohet në një strukturë të re, që e dimë se është quajtur Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) e që dhe kjo, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, do të shuhet. Vini re! Do të shuhet.

Do të shuhet e jo do të transformohet nga TMK në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) që, kundruar nga këndvështrimi politik, nuk është e njëjta gjë, me atë procesin e mëparshëm të transformimit të UÇK-së në TMK.

Por a përmbillet i gjithë kapitulli i historisë së kësaj ushtrie pas transformimit të saj në TMK dhe shuarjes së TMK-së më vonë?

Jo.

Para se të shpalos disa çaste të fazave nëpër të cilat ka kaluar historia e krijimit, e zhvillimit dhe e shuarjes së kësaj ushtrie (Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës), më duhet ta vë në pah se ajo (UÇK-ja), si e tillë, me luftën që ka bërë, paraqet kurorëzimin e përpjekjeve të shqiptarëve për çlirim nga ish-Jugosllavia e të gjitha formave të rregullimit të saj (monarkiste, republikane, moniste, pluraliste etj.).

Për mendimin tim, e gjithë historia e zhvillimit dhe e luftës që ka bërë kjo ushtri ka kaluar nëpër tri faza, që e kanë karakterizuar me vështirësi të shumta dhe dinamikë, po ashtu të shumtë, në përmbajtje dhe heroizëm e diplomaci në veprim, për një periudhë mjaft të shkurtër (rreth pesë vjet) të ekzistencës së vet.

Me këtë rast nuk duhet harruar as parahistorinë e saj por që, duke pasur parasysh natyrën e këtij tubimi shkencor, nuk mendoj se është e nevojshme të lëshohet në një analizë të hollësishme të asaj periudhe, për arsien e thjeshtë, se UÇK-ja, mendoj unë, është e rëndësishme jo për atë që i ka paraprirë formimit të saj, por më shumë, jetësisht më shumë, për atë që ka qenë gjatë ekzistencës së vet dhe për efektet që ka prodhuar në saje të asaj ekzistence.

Megjithatë, fare shkurt do të mund të thuhet në këtë rast disa fjalë edhe për këtë periudhë.

Nëse për demonstratat e vitit 1981 mund të thuhet se nxorën në skenë çështjen e pazgjidhur të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, UÇK-ja me luftën e saj imponoi domosdoshë e zgjidhjes së një pjese të kësaj çështjeje, atë të Kosovës.

Po cilat ishin fazat nëpër të cilat ka kaluar historia e kësaj ushtrie?

## Faza I

UÇK-ja është themeluar më 17 nëntor 1994.

Ky ishte një akt, ndërsa themelimi dhe organizimi i

kësaj ushtrie ishte një proces që ka parahistorinë dhe historinë e vet.

Mund të thuhet kështu, sepse akti i themelimit të UÇK-së nuk mund të trajtohet si një moment i izoluar nga koha pararendëse dhe paskoha që i vjen kësaj date.

Akti i themelimit të UÇK-së është rezultat i një historie më të gjatë dhe ka një sfond politik dhe kombëtar të krijimit të vet. Po cili ishte ky sfond politik në të cilën u krijua kjo ushtri?

Shtirja e këtij sfondi në thellësi kohore tregon dhe mesjetën, por atë vetëm përmes ideve të Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve. Por, formësimin e saj embrionale duhet kërkuar te kjo Rilindje e këtej, e sidomos pas vitit 1913, kur kishte përmbyllur punimet Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe pjesën më të madhe të trojeve shqiptare, përfshi dhe Kosovën, e kishte shkëputur nga trungu amë.<sup>1</sup>

Por, le të kthehemi tek e djeshmja e afërt.

Rreth një dekadë pas demonstratave të vitit 1981 filloi të ndihet më e afërt fryma e një ndryshimi, jo vetëm në ish-Jugosllavi, por gjithandej Evropës Lindore.

Pikërisht në prag të jetësimit

këtij ndryshimi, hegjemonizmi serb ia del t'i imponojë ndryshimet kushtetuese të cilat, shqiptarëve në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti, ua rënduan më shumë jetën politike dhe shoqërore. Pas aprovimit të këtyre ndryshimeve dhe në saje të tyre jeta institucionale u paralizua pothuajse plotësisht. Ndryshimet kushtetuese të cilat, pavarësisht prej vullnetit të popullsisë që të mos lejoheshin (por jo dhe të politikës dhe një pjese të inteligjencës sonë të asaj kohe), u formalizuan në mbledhjen e Kuvendit të KSA të Kosovës më 23 mars 1989 e pas një jave, më 28 mars 1989, në Kuvendin e RS të Serbisë, në Beograd. Për shqiptarët e Kosovës këto ndryshime shënuan regresin më të madh që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Me anë të tyre KSAK-së iu mor edhe ajo shtetësi e paktë që e kishte deri në këtë kohë.

Okupimi klasik i cili pasoi këto zhvillime politike rezultoi me përjashtimin e shqiptarëve pothuaj nga të gjitha sferat e jetës politike dhe institucionale. Ata, që të mos i nënshtroheshin këtij okupimi, filluan të bëjnë një lloj organizimi paralel të jetës politike (organizimi në parti dhe shoqata të ndryshme)



dhe, pse jo, edhe institucionale (këtu duhet pasur parasysh sidomos shkollimin e të gjitha niveleve dhe shëndetësinë), por që koha me rrjedhën e vet po e dëshmonte se nuk ishte e mjaftueshme për të ardhur deri te çlirimi, përkatësisht deri te liria e plotë e tyre, të cilën e kishin aspiruar me dekada, prej kohës së ndarjes nga trangu amë, më 1913 e këtej.

Përveç organizimeve politike legale, të cilat monitoroheshin pothuaj plotësisht nga shteti i Jugosllavisë së asaj kohe e sidomos nga Republika e Serbisë që në këtë kohë e kishte instaluar kontrollin mbi çdo pore të jetës së shqiptarëve, për fat të mirë, kishte edhe organizata të fshehta antipush-tuese që kishin një përvojë më të gjatë veprimi në këtë mënyrë. Të tilla ishin sidomos LPK dhe LKÇK.

Pikërisht në një sfond të këtyllë politik, kombëtar dhe shoqëror, lindi UÇK-ja, në saje të një vendimi të LPK-së të datës 17 nëntor 1994, në mbledhjen e Kryesisë së saj, në Arau të Zvicrës.

Kjo datë paraqet pikënisjen e fazës së parë të kësaj ushtrie.

Sprova kryesore që do ta përshkrojë këtë fazë mund të përmbledhet me dy fjalë: A do të mund të bëhej ushtria?

Për t'u realizuar bërja e kësaj ushtrie duhej të kalonte shumë sprova të tjera, herë të njëkohshme, herë të njëpasnjëshme, derisa nuk legalizohet më 28 nëntor 1997. Këto sprova ishin të kushtëzuara nga ndërthurja e faktorëve të shumtë, duke filluar prej atyre historikë e deri te faktorët politikë.

Ishte e detyruar të formësohej, zhvillohej dhe të zgjerohej në fshehtësi të thellë, me numër të kufizuar pjesëtarësh, me vështirësi të furnizimit me armatim dhe, sidomos, me një injorim politik nga organizimet politike në Kosovë (në disa raste dhe me akuza të rënda në adresë të saj<sup>2</sup>) që po ushtronte veprimtari "legale" në bazë të legjislacionit të ish-Jugosllavisë së mbetur (Serbi - Mali i Zi).

Edhe në raport me shtetin amë - Shqipërinë - kishin ndryshuar rrethanat politike. Forcat e reja që kishin ardhur në pushtet, LPK-në dhe krijesën e saj, UÇK-në, nuk i shikonin me sy të mirë për shkak të, goja, orientimit të tyre majtist dhe traditës së lidhjeve të kësaj organizate me ish-partinë shtet të kohës së monizmit. Në fakt, e vërteta në lidhje me këtë pretendim nuk mund të shpjgohet në këtë mënyrë, sepse këto organizata të fshehta nuk i kishin të konsoliduara lidhjet për arsye ideologjike, por për arsye praktike dhe ishin lidhje dhe raporte me shtetin shqiptar.

Kështu, nëse mund të thuhet se lëvizjet e pjesëtarëve të UÇK-së në ish-Jugosllavinë e mbetur ishin të vështira, në shtetin

shqiptar tani u bënë më të kufizuara. Megjithatë, UÇK-ja, siç dihet tanimë pothuajse nga të gjithë, pavarësisht prej këtyre pengesave dhe vështirësive, ia kishte dalë të mbijetonte dhe, gradualisht, të konsolidohej për t'i dhënë vulën e vet një kohe të mëvonshme që paraqet fazën e dytë dhe më kulmore të veprimtarisë së saj.

Ajo është periudha e viteve 1997-1999.

## Faza II

Më 28 nëntor 1997, tre ushtarë të UÇK-së (Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe Daut Haradinaj), në Llaushë të Skenderajt do të paraqiten në varrimin e mësuesit Halit Geci, i vrarë nga forcat serbe një ditë më parë, dhe do ta dëshmonin publikisht ekzistencën e UÇK-së, për të cilën deri në këtë kohë flitej me dyshim.

Ky çast ishte pritur me entuziazëm nga qytetarët.

Akti i flijimit të familjes Jashari në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars 1998, përkundër asaj që kishte synuar e planifikuar shteti i Serbisë, i dha luftës një impuls të ri, por edhe për UÇK-në ishte një sprovë e re, sepse tani i duhej ta përballonte edhe presionin publik të popullsisë e cila manifestonte një entuziazëm dhe gatishmëri të paparë që të rreshtohej e t'i kapte armët e kësaj ushtrie.

UÇK-ja nuk e kishte atë mundësi që t'i përgjigjej pozitivisht kësaj kërkesë. Derisa veshmbathja dhe ushqimi nuk ishin problem, armatimi, që në këtë kohë duhej më shumë se buka, ishte elementi më i vështirë për t'u siguruar.

Sprova e fazës së parë, se a do të mund të bëhej ushtria, në fazën e dytë kishte ndryshuar. Prapë si mundësi, por me një qëllim tjetër. A do të mund të bëhej lufta?

Qëndresa heroike dhe flijimi i familjes Jashari nuk pati ndikim vetëm te faktori i brendshëm, por sidomos tek ai i jashtëm. Këtë na e dëshmon ish-sekretarja shtetërore e ShBA-së, znj. Medlin Ollbrajti (Madeleine Albright), në librin e saj autobiografik "Zonja sekretare" ku, duke iu referuar luftës së familjes Jashari, shkruan: "Po të kish qenë një incident i veçantë, do të kishte qenë një tragjedi pa ndonjë ndikim në shkallë botërore, por vrasjet (në familjen Jashari - B. Z.) duheshin parë në kontekstin e tyre historik".<sup>3</sup>

Ky kontekst historik, të cilin e thekson znj. Ollbrajt, zë fill që nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913, atëherë kur, siç thotë prof. dr. Arben Puto, "në kundërshtim me parimin e kombësisë dhe pa marrë parasysh fare shprehjen e vullnetit të popullsisë vendëse, Shqipërisë iu shkëputën krahina të tëra si Kosova, Rrafshi i Dukagjinit dhe tokat shqiptare



të pjesës perëndimore të Maqedonisë"<sup>4</sup> dhe i ishin dhënë Serbisë e Malit të Zi.<sup>5</sup>

Pra, qasja e aktorëve me ndikim në faktorin ndërkombëtar, ShBA-së në këtë rast përmes sekretares shtetërore ndaj këtij akti, shënon një kërcim cilësor, sepse luftën e familjes Jashari nuk e konsideroi si një "incident" të izoluar por, duke e vënë në kontekstin historik të zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë, mundësoi krijimin e një parakushti të favorshëm për ndërgjegjësimin e mëvonshëm të tij, angazhimin e cili, siç do të shihet më vonë, do të përfaqësohet dhe mbrohet nga ShBA-ja në rend të parë, pastaj nga Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe vende të tjera të botës perëndimore.

Por le të kthehemi në zhvillimet e ngjarjeve të vitit 1998-1999, në Kosovë dhe rreth saj që, sido që ta marrësh, nuk mund t'i shkëpusësh nga vendimet e asaj Konferencë, sepse janë pasojë e tyre.

Luftërat janë fenomene komplekse dhe komponentë e rëndësishme, për të mos thënë vendimtare, është gjetja e aleatëve dhe përfitimi i përkrahjes së tyre si dhe bashkëpunimi me ata që mbështesin kauzën e për të cilën fillohet lufta. Nga kjo e vërtetë s'ka se si të bënte përjashtim dhe lufta e UÇK-së. Prandaj, drejtuesit e saj do të nisin të bëjnë kontakte me faktorët me ndikim dhe vendimmarrës në politikën ndërkombëtare. Këto kontakte, në krye të herës do të bëhen, larg syrit të opinionit publik që më i rëndësishmi ishte takimi i parë i z. Hollbruk me

përfaqësuesit e UÇK-së në Zvicër.<sup>6</sup> Pas rreth një muaj po ky ambasador do ta bëjë takimin e dytë, në Junik, më 24 qershor 1998<sup>7</sup> që, sipas Bedri Islamit, nuk ishte asgjë tjetër, përpos njohje "faktike e saj (UÇK-së - B. Z.) si forcë politike e jo vetëm ushtarake".<sup>8</sup>

Në fakt, ky ishte "qëndrimi i ri amerikan ndaj UÇK-së"<sup>9</sup>, siç konstaton me të drejtë Paskal Milo, ministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë në atë kohë, qëndrim që s'do mend se i dha një shtysë të fortë promovimit të UÇK-së si forcë politiko-ushtarake në arenën ndërkombëtare.

Depërtimi në arenën ndërkombëtare dhe vënia e relacioneve të nevojshme me faktorët e duhur ndërkombëtarë ishte një domosdoshmëri tjetër për UÇK-në, në këtë kohë dhe, edhe këtë domosdoshmëri UÇK-ja po e përmbushte me sukses.

Bashkëpunimit me faktorin ndërkombëtar, që ishte një front më vete, UÇK-ja i kushtoi vëmendje e duhur dhe arriti t'i japë zgjidhjen e duhur. Në saje të tejkallimit me sukses të kësaj sfide, pak më pak se një vit pas fillimit të luftës në përmasa më të gjera, bota demokratike do ta pranojë arsyeshmërinë e kësaj lufte dhe do të angazhohet për t'i gjetur një zgjidhje të lakmueshme. Prandaj, për këtë arsye dhe u thirr dhe u mbajt ajo që tani njihet si Konferenca e Rambujesë (6 - 23 shkurt)<sup>10</sup> dhe 14-19 mars 1999<sup>11</sup>, nga e cila rezultoi ndërhyrja ushtarake e NATO-s me sulme ajrore kundër infrastrukturës dhe segmenteve të sigurisë të shtetit të ish-Jugosllavisë, respektivisht

kundër Serbisë, pasi që kjo e fundit diktonte krejtësisht politikën e asaj federate jugosllave që kishte mbetur pas shkëputjes së Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinës.

Në një takim të kryesisë së delegacionit që e përfaqësonte Kosovën në këtë Konferencë (Hashim Thaçi - kryetar, ndërsa Ibrahim Rugova dhe Rexhep Qosja - anëtarë) me ministrin e Punëve të Jashtme të Italisë, z. Lamberto Dini që, në emër të Grupit të Kontaktit, kishte shkuar në Rambuje, përkundër faktit që ai dhe vendi i tij kishin një lloj rezerve dhe hezitonin për përkrahjen e luftës së UÇK-së. Ai, ndër të tjera, deklaroi: "Suksesi (e ka fjalën për suksesin e Konferencës që duhet të jetë marrëveshja - B. Z.) duhet të arrihet sepse ju keni luftuar për të. Po të mos kishit luftuar, autoritetet e Beogradit nuk do të vinin këtu".<sup>12</sup>

Me Marrëveshjen që nënshkroi delegacioni i Kosovës, në krye të të cilit ishte drejtori i Drejtorisë Politike të UÇK-së, z. Hashim Thaçi, UÇK-ja e plotësoi veten dhe me një tjetër lloj arme - ajrore, e cila ishte në pronësi të strukturës më të fuqishme ushtarake në historinë e njerëzimit - NATO dhe udhëhiqej e përdorej prej saj kundër Serbisë gjakatare.

Luftimet që po zhvilloheshin në terren nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të plotësoheshin me sulmet e NATO-së që filluan më 24 mars 1999 dhe që i dhanë vulën përfundimtare çlirimit të Kosovës.

Pas 78 ditë sulmesh, më në fund Serbia pranon të dorëzohet, por vetëm para faktorit



ndërkombëtar. Ky akt formalizohet me Marrëveshjen e Kumanovës.

Edhe kjo fazë që, kuptohet, ishte ndër më të vështirat, sepse politika jo që nuk i jepte mbështetje UÇK-së dhe luftës së saj por, për më tepër, vazhdonte ta kundërshtonte atë si “të paduhur”, “të panevojshme”, “të nxituar”, “aventuriere”, për të mos thënë edhe “të gabuar”, u përmbyll me sukses.

### Faza III

Pas Marrëveshjes së Kumanovës dhe miratimit të Rezolutës së KS të OKB-së me nr. 1244, në qershor të vitit 1999, brenda pak ditësh, në Kosovë u dislokuan administrata e UNMIK-ut dhe forcat e KFOR-it.

Ky veprim do të pasohet me bisedimet për t'i gjetur një zgjidhje problemit të UÇK-së dhe pak më pak se tre muaj pas përfundimit të luftës, saktësisht më 19 shtator 1999, në praninë edhe të komandantit të NATO-s, Vesli Klarkut, përkundër dëshirës së drejtuesve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, do të bëhet transformimi i saj në TMK, që ishte një lloj vazhdimësie e të parës, pavarësisht se kishte emër të ri. Transformimi i UÇK-së në TMK mund të pranohet si i arsyeshëm, sepse tani në Kosovë ishte dislokuar NATO përmes strukturës së saj KFOR, dhe misioni i asaj që e trashëgoi TMK-ja ishte i ri, ngaqë kishin pushuar rrethanat e luftës.

TMK-ja do të funksionojë si e tillë deri më 21 janar të vitit 2009, kur do të bëhet shuarja e saj dhe do të formohet FSK-ja. Për mua këtu përmbillet historia e ekzistimit të UÇK-së. Përmbillet kapitulli i të bëmave të saj si strukturë politiko-ushtarake por, si për ironi, kjo gjë nuk do të ndodhë dhe për themeluesit, drejtuesit dhe pjesëtarët e saj.

Administrata e UNMIK-ut, pas saj edhe e EULEX-t, paralelisht me hetimet për krime të luftës të palës serbe, do t'i fillojnë dhe do t'i bëjnë edhe ndaj pjesëtarëve të UÇK-së.

Një gjë e tillë kishte ardhur si rrjedhojë e një fakti të cilin vite më parë e kishte pikasur Arbën Xhaferi dhe e kishte vlerësuar si lëshim të faktorit ndërkombëtar që, edhe pas katër luftërave që ishin bërë në ish-Jugosllavi (Slloveni, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë) nuk e kishte definuar fajtorin, paçka se Serbia kishte qenë shkaktarja e secilës prej këtyre katër luftërave.

Kjo qasje, në rastin e Kosovës dhe me UÇK-në, mëtonte (dhe jo pa sukses ia doli) që t'i barazonte palët duke i konsideruar të dyja fajtorë. Në saje të kësaj filloi një gjueti e ethshme kundrejt pjesëtarëve të UÇK-së, dhe grupe të shumta të tyre të zonave të ndryshme të UÇK-së u arrestuan dhe u



gjkuan e dënuan me vite të tëra burgim.

Megjithatë, si duket kishte të atillë që nuk u kënaqën me atë që u bë kundër pjesëtarëve të UÇK-së nga gjykatat ndërkombëtare (UNMIK dhe EULEX) në Kosovë dhe në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës, ku u gjykuan dhe dy nga figurat e rëndësishme të luftës sonë, Fatmir Limaj dhe Ramush Haradinaj.

Të tillët vazhduan të bironin e zhbironin mundësi që të gjenin ndonjë formë apo ndonjë arsye për ta vazhduar përpjekjen me të vetmin qëllim që ta komprometonin luftën e UÇK-së dhe, rrjedhimisht, edhe NATO-n që gjatë kohës së luftës i kishte dhënë mbështetje luftës së kësaj ushtrie. Këto përpjekje u shtuan sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008. Dhe u gjetën argatët e errësirës, sepse të tillët nuk kishin munguar as gjatë kohës së luftës. Le ta kujtojmë në këtë rast qëndrimin e Rosisë, i cili shpaloet në një shkrim të gazetës ruse *Izvestia* më 22 korrik 1998. Kjo gazetë në këtë artikull i referohet luftës së Rahavecit të datës 17 deri më 21 korrik të vitit 1998, me ç'rast, përveç që shpaloet qëndrimin solidarizues të Moskës zyrtare me Beogradin, shprehet edhe kundrejt luftës së UÇK-së, duke ua hedh shqiptarëve “gjithë fajin për acarimin e situatës”.<sup>13</sup>

Pa u plotësuar as një dekadë nga koha e përfundimit të luftës së Kosovës, fillimisht ish-prokurorja e Tribunalit të Hagës për krimet e luftërave në Jugosllavi, në librin e saj të titulluar “Gjuetia - unë dhe kriminelët e luftës” e kishte bërë publik idenë se, gjoja, pjesëtarët e UÇK-së kanë bërë krime monstruoze. Them idenë, por jo dhe faktet, sepse po të ishte e vërtetë ajo që thuhet në këtë libër nga autorja, ish-kryeprokurorja nuk do të kishte kursyer asgjë për ta ndriçuar të vërtetën sa ka qenë kryeprokurore e Tribunalit të

Hagës, sepse e ka pasur dhe detyrim ligjor e jo tani ta bënte këtë përmes propagandës. Megjithatë, kjo ide që ishte lansuar nga ky libër në formë tullumbaceje, ishte brumi fillestar që më 2008 që do të merret nga deputeti rus Konstantin Kosaçev, për t'ia dorëzuar pastaj stafetën kryetarit të Komisionit për Politikën e Jashtme në Këshillin e Shteteve të Konfederatës Helvetike, Dik Martit. Ky i fundit, i yshtur mbase dhe nga anti-amerikanizmi i tij i theksuar<sup>14</sup>, duke iu kundërvënë politikës zyrtare të Zvicrës, e cila ishte ndër të parat shtete që e njohu Pavarësinë e Kosovës, në dhjetor të vitit 2010 doli me një Raport që e dërgoi për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe kjo Asamble e miratoi atë Raport që, siç do ta dëshmojnë hetimet e mëvonshme, do të rezultojë të jetë i trilluar ngaqë asgjë nga pretendimi se ka pasur trafikim organesh nuk do të vërtetohet jo nga gjykata, por as edhe nga hetuesia dhe prokuroria që do të bëjnë punën paraprake. Me këtë rast, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e, mbase, vetë Dik Marti, do të futen në lajthitje nga Konstatn Kosaçevi prej Rosisë.

Miratimi i këtij Raporti prodhoi jo vetëm efekt juridik por, pse jo, dhe moral e politik.

Për pasojë, pas miratimit të këtij Raporti, qasja e mëparshme e botës demokratike ndaj shqiptarëve dhe sidomos ndaj UÇK-së do të përmbysat pothuaj tërësisht.

Formalizimi i Raportit krijoi një parakusht të pashmangshëm në bazë të të cilit do të fillojë të trajtohet ky pretendim dhe, për pasojë, do të vihen në lëvizje politikanë, shtete e mekanizma ndërkombëtarë, përkrahës të luftës së djeshme të UÇK-së, dhe do të kërkojnë nga udhëheqja e Kosovës që të formojnë një tip gjykate që, unë

nuk di të ketë ekzistuar më parë në ndonjë vend tjetër të botës dhe për ndonjë luftë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 3 gusht të vitit 2015, kuptohet nën presionin e kësaj trysnie të madhe politike dhe diplomatike, miraton Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar.

Këto dhoma u imponuan nga vendimi i sipërpërmendur, bazuar mbi një akuzë krejtësisht politike e të pavërtetë, e ideuar e hartuar më parë nga një politikan, sipas të cilit, “struktura të UÇK-së kanë kryer trafik të organeve të qenieve njerëzore me robërit e luftës”, por që nuk u vërtetuan (nuk u vërtetuan se nuk ka pasur nga hetimet paraprake të Klint Williamsonit (Klint Viliamson), që rezultuan si rrjedhojë e aprovimit të Raportit. Megjithatë, pavarësisht se këto pretendime nuk u vërtetuan, Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar ngelën.

Ky pretendim ishte një akuzë e re e monstruoze, që legjitimoi politikisht shkeljen e parimit të mosgjykimin të gjësë së gjykuar, madje nga një gjykatë në hierarki më të ulët se gjykata a mëparshme që ishte Tribunali i Hagës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, një rast ky i paprecedent në të drejtën ndërkombëtare e në praktikën e çdo shteti demokratik.

Mbi bazën e këtij ligji, tani, pothuaj të gjithë drejtuesit kryesorë të UÇK-së gjenden në paraburgim dhe presin gjykimin.

Dhomat e Specializuara janë një precedent historik; ato janë imponuar me vendim politik të Këshillit të Evropës, bazuar mbi një aktakuzë publike, gjithashtu politike. Po të kishte diçka faktike, do të ishte e pamundur që të mos i binte në gjurmë prokuroria e Tribunalit të Hagës për luftërat në ish-Jugosllavi, Tribunali i cili ka bërë hetime dhe ka zhvilluar gjykime, siç e

thash më lart, edhe për UÇK-në. Nisur nga ky fakt, tani natyrshëm na imponohet pyetja se: si është e mundur që të gjitha krimet e luftërave që pasuan shkatërrimin e RSFJ-së, përfshirë dhe ato të shkaktarit kryesor të këtyre luftërave - shtetit të Serbisë, të trajtohen vetëm nga Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë dhe nga gjykatat vendëse, ndërsa për pjesëtarët e UÇK-së, përveç këtij Tribunali dhe gjykatave të UNMIK-ut dhe EULEX-it (gjykata që më së paku mund të quhen vendore), të ngrihet edhe një mekanizëm i veçantë, i paparë në historinë moderne, të emërtuara Dhoma të Specializuara që ndjekin krimet mbi bazën e kriterit etnik, më saktë vetëm “të përkatësisë” së UÇK-së?!

Për më tepër, është i paparsyeshëm zgjerimi i fushëveprimit të Ligjit për Dhomat e Specializuara përkritazi me lëndën arkivore të punës së këtyre dhomave dhe instancave të tjera, nën parimin “lex specialis”.

Këtu do të ndalesha te dy paragrafët e Nenit 62 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e

Prokurorit të Specializuar.<sup>15</sup> Ç’emërtim interesant?!

“Dhomat e specializuara”, që nënkupton gjykatat dhe “Prokuroi i specializuar”!

Emërtimet e këtyra na thonë se këta (gjykatësit dhe prokurorët e mandatuar me këtë ligj) janë të specializuar. Kjo gjë i bën ata të ndryshëm nga gjykatësit e prokurorët e tjerë (të Tribunalit të Hagës, përfshirë dhe ata të UNMIK-ut, EULEX-it, por dhe vendorë), sepse janë “të specializuar”. Po gjykatësit dhe prokurorët e Tribunalit të Hagës për Jugosllavinë, të UNMIK-ut dhe EULEX-it që, po ashtu, me mandat ligjor kanë pasur obligim dhe i kanë hetuar krimet e luftërave në ish-Jugosllavi, përfshirë dhe Kosovën<sup>16</sup>, deri në miratimin e Rezolutës së Dik Martit nga Këshilli i Evropës), nuk kanë qenë të specializuar?!

Praktika na tregon se mund të ketë gjykatës e prokurorë të mirë, më të mirë dhe shumë më të mirë, të zotë ose shumë më të zotë, por të ketë dhe gjykatës e “prokuror të specializuar”, që nënkupton dhe të kundërtën, të paspecializuar, këtë nuk e kam dëgjuar ndonjëherë.

Por le të kthehemi te përmbajtja e dy dispozitave të nenit 62 të ligjit që e theksova më lart.

Në to thuhet:

1. Duke i pasur parasysh rrethanat e sigurisë dhe privatësisë, dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Regjistrimit dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës. E drejta e përgjithshme për të pasur qasje në të dhënat apo arkivat e



Dhomave të Specializuara, përfshirë të Zyrës së regjistrimit dhe të Zyrës së Prokurorit të specializuar, nuk ekziston (nëviz. imi – B.Z.)

Ky mohim i të drejtës, për të pasur qasje në dokumentacionin që prodhojnë këto dhoma të cilat janë institucione të Republikës së Kosovës, nuk nënkupton vetëm mohimin e të drejtës për të pasur qasje personat fizikë që mund të jenë studiues dhe hulumtues të ndryshëm në të ardhmen por, për më tepër, duke saktësuar se dokumentet që prodhojnë këto dhoma që thonë se janë institucione të Kosovës nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës, e privon shtetin e Kosovës dhe sidomos Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës nga e drejta e pasjes në administrim të një sasive të konsiderueshme të materialit arkivor të cilin institucioni ynë - Arkivi i Kosovës - është përgjegjës për ta mbledhur, ruajtur dhe dhënë për shfrytëzim sipas legjislacionit që është në fuqi.

Me këtë ligj, dorëzimi i dokumentacionit që do të prodhojnë këto dhoma dhe kjo Prokurori, rrjedhimisht dhe pranimi nga ana e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, nuk do të bëhet asnjëherë. Dokumentacioni që do të prodhojnë këto institucione nuk do të kthehen në Kosovë dhe, rrjedhimisht, nuk do të dorëzohen në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës siç rregullohet kjo çështje me Ligjin për Arkivat nr. 08/L-111, konkretisht me paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 13 të këtij ligji. Mospërfillja e këtyre dy dispozitave do të rezultojë me një të vërtetë të hidhur. I gjithë fondi i dokumentacionit që do të prodhojnë këto dhoma deri në momentin e shuarjes së tyre nuk do të dorëzohet në Agjenci si institucioni i vetëm përgjegjës për ruajtjen dhe për administrimin e dhënien për shfrytëzim të materialit arkivor të Kosovës, jo vetëm pas shuarjes së tyre siç rregullohet kjo çështje me paragrafin 3 të këtij neni, por duke mos i konsideruar dokumente publike të Kosovës, ato nuk do të dorëzohen në ASHAK edhe pasi ta përmbushin afatin prej 30 vjetësh siç thuhet në paragrafin 2 të të njëjtit nen dhe ligj.

Kësisoj, Arkivi Qendror, që është një prej arkivave që me ligj definohet se është institucion shtetëror ose joshtetëror i specializuara që mbledh, përpunon, administron, ruan dhe e ofron për shërbim pasurinë arkivore e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti,<sup>17</sup> privohet nga e drejta e pranimit dhe e posedimit të atij numri të dokumentacionit që do të prodhohet nga këto dhoma. Kjo për Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, në kuadër

të së cilës është edhe Arkivi Qendror, paraqet jo vetëm një mosbesim në këtë institucion për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me mandat ligjor por, për më tepër, edhe një privim të tij nga e drejta e posedimit të një pjese të thesarit arkivor me vlera të veçanta për historinë e re të Kosovës si vend dhe sidomos si shtet i cili ka rezultuar si produkt i natyrshëm i një lufte titanike me të cilën, tani, 20 vjet pas përfundimit të saj dhe 12 vjet pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ka filluar një odisejadë e re e marrjes me atë luftë.

Ky paragjykim për ASHAK-në si institucion përgjegjës për ruajtjen e pasurisë arkivore të Kosovës, i normëzuar tani me ligj, ishte arsyeja e dytë, pas asaj të parës që ishte Raporti i Dik Martit, të cilat drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, z. Ardit Bido dhe mua, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, në krye të herës, na e ngacmoi idenë për të dalë me një reagim të përbashkët të dy institucionet tona. Kjo gradualisht u formësua dhe si reagim kundrejt një padrejtësie që po i bëhej luftës së shqiptarëve për çlirim, për barazi dhe të drejta të plota siç i gëzojnë të gjithë qytetarët e kontinentit të Evropës.

Kësaj nisme menjëherë iu bashkua edhe Instituti Albanologjik i Prishtinës, respektivisht drejtori i këtij Instituti, prof. dr. Hysen Matoshi, për t'u zgjeruar më tej dhe me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë dhe institucionet e tjera me të cilat kemi hartuar dhe një deklaratë kundër kësaj padrejtësie që po i bëhet luftës së UÇK-së dhe gjithë Kosovës e të cilën e kanë nënshkruar drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse në këtë sesion shkencor.

Deklaratën e kemi publikuar më 25 nëntor 2020, datë në të cilën kishim planifikuar ta mbanim këtë sesion shkencor, por që qemë të detyruar ta shtyjme për shkak të masave kufizuese kundrejt pandemisë Covid-19.

## Përfundim

Nga sa u vu në pah më lart, mund të përfundoj se qasja e drejtësisë, duke manifestuar paragjykim të nënkuptuar ndaj një etnie, si në këtë rast kundër UÇK-së që, siç thashë në fillim, është produkt i një përpjekjeje të gjatë të shqiptarëve për çlirim dhe liri njerëzore, nuk është rruga e duhur për të shkuar drejt një kuadri të vlerave e synimeve shoqërore e kolektive të përbashkëta, sipas shembujve të shteteve më të përparuara për

respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, demokracisë liberale dhe të shtetit të së drejtës.

Sipas gjykimit tim, dhe mendoj se kam të drejtë në këtë që e them, kjo lëndon rëndë parimet themelore të drejtësisë, më saktë është në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve para ligjit që drejtësia e çdo vendi dhe e çdo institucioni përgjegjës për ndarjen e saj duhet ta ketë alfën e saj.

Duke i sendërtuar këto dhoma me një ligj të tillë, kuptohet për shkak të një trysnie ndërkombëtare, kemi krijuar kushtet për një ndërmarrje juridike në emër, të gjoja, drejtësisë por që, në fakt, nuk është asgjë tjetër përpos mundësi ligjore për realizimin e përpjekjeve të qarqeve e individëve të caktuar për të përbaltur e deformuar të vërtetën historike.

UÇK-ja në krye të herës ka qenë fryt i një reagimi të shqiptarëve kundër robërisë dhe shtypjes së gjatë të shtetit të Serbisë, ndërsa lufta e saj ishte përpjekje për mbrojtje të ligjshme të shqiptarëve nga dhuna, dëbimet, shpërnguljet dhe vrasjet masive të shtetit të Serbisë, me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës. Pra, lufta e saj, që nënkupton dhe luftën e shqiptarëve të Kosovës, ishte luftë çlirimtare.

Lufta çlirimtare, e udhëhequr nga UÇK-ja, në thelbin e saj programor, kishte shpëtimin e qenies etnike shqiptare nga shfarosja, mbrojtjen e ndaljen e krimeve ndaj shqiptarëve dhe jo ushtrimin e tyre ndaj të tjerëve. Çdo deformim i rolit të UÇK-së, i misionit dhe qëllimit themelor të saj; çdo njollosje e kategorizim i UÇK-së si një ndërmarrje kriminale e jo si një ushtri popullore, vullnetare, çlirimtare e vetëmbrojtëse, përbën në vetvete një përpjekje për të njollosur jo individë të caktuar, por vetë vlerat kombëtare të popullit shqiptar të Kosovës, si një popull liridashës e paqësor, si një popull viktimë e spastrimeve etnike e jo nxitës e promotor i politikave gjenocidiale. Për më tepër, kjo është një përpjekje për t'i minuar themelet e shtetit të Kosovës, ngrehina e të cilit, pa

luftën e UÇK-së, as që mund të paramendohet.

Nga sa u tha më lart, rrjedh se UÇK-ja me luftën e saj tani më është pjesë e historisë së kombit tonë dhe, edhe pse pati një histori të shkurtër, ajo i ka dhënë vulën e vet historisë më të re të Kosovës dhe jo vetëm asaj. Por në të njëjtën kohë, edhe pse në luftën e saj (UÇK-së) u mishërua rezistenca kundër shtypjes dhe robërisë njëshekullore dhe morën vlerë sakrificat e brezave të tërë për liri kombëtare, barazi e drejtësi sociale për shqiptarët e Kosovës, si asnjë rast tjetër, "drejtësia" rend pas saj si një hienë e pangopur.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke qenë organikisht e lidhur me historinë e kombit shqiptar, si asnjë strukturë tjetër, ndanë fatin me këtë histori, të vërtetën e së cilës, Xhevahir Spahiu, në poezinë "Historia jonë", e ka skalitur me vargjet: *ehut të shpatës kemi ecur rrufe / Pastaj shpata ka ecur mbi ne.*<sup>18</sup>

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

<sup>1</sup> Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Dudaj, Tiranë 2010, f. 144.

<sup>2</sup> Bedri Islami, në librin e tij *Triada e Kosovës*, [Autori], Tiranë, 2021, përveç të tjerave, në f. 173-174 sjell dhe këtë shënim: *Më 25 mars 1998, kur në Kongresin Amerikan po dëgjoheshin dëshmitë për Kosovë, pyetjes së ambasadorit Gelbard drejtuar kryeministrit në ekzil, z. Bujar Bukoshi, se ç'mendim kishte për UÇK-në, z. Bukoshi i ishte përgjigjur: Ushtria Çlirimtare e Kosovës është një grupacion i njerëzve të frustruar, fshatarëve injorantë,*

*të manipuluar nga fundërrinat e marksizëm-leninizmit dhe të sigurimit të Enver Hoxhës të cilët me veprimet e tyre terroriste (Vini re: terroriste, - B. Z.) provokojnë policinë serbe".*

<sup>3</sup> Madeleine Albright, *Zonja sekretare, Dudaj*, Tiranë 2004, f. 442.

<sup>4</sup> Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Dudaj, Tiranë 2010, f. 144.

<sup>5</sup> Më gjerësisht për këtë çështje shih kapitullin VI, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Dudaj, Tiranë 2010, f. 129-154.

<sup>6</sup> Më gjerësisht shih te Bedri Islami, *Triada e Kosovës*, Tiranë 2021, f. 281-304.

<sup>7</sup> Hajdin Abazi, *Takimi në Junik, takimi i parë publik diplomatik ShBA-UÇK*, AAB, Prishtinë, f. 27.

<sup>8</sup> Bedri Islami, *Triada e Kosovës*, Tiranë 2021, f. 170.

<sup>9</sup> Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001*, Toena, Tiranë, 2009, f. 73.

<sup>10</sup> Në Konferencën e Rambujesë delegacioni i shqiptarëve, duke e caktuar Hashim Thaçin shef, i dha fuqi legjitimitetit të luftës së UÇK-së. Për këtë më gjerësisht në pjesën *Zgjedhja e Shefit të Delegacionit*, në librin e Rexhep Qosjes *Paqja e përgjakshme*, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë, 2020, f. 33-36.

<sup>11</sup> Më gjerësisht shih te Ramë Buja, *Konferenca e Rambujesë*, Prishtinë 2006, f. 57-147 dhe te Ramë Buja, *Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë*, Universiteti AAB, Prishtinë, 2007, kapitulli i pestë, f. 299-453.

<sup>12</sup> Rexhep Qosja, *Vepra XIX, Paqja e përgjakshme*, Institutit Albanologjik, Prishtinë 2010, f. 119.

<sup>13</sup> Më gjerësisht shih te Shaqir Vukaj, *Rusia dhe Kosova, shënime të një diplomati*, Tiranë, 2007, f. 162 e tutje.

<sup>14</sup> Mund të thuhet kështu sepse ShBA-ja, së bashku me Britaninë e Madhe, ishin mbështetësit kryesorë të luftës së UÇK-së dhe udhëheqësit e fushatës së bombardimeve të infrastrukturës së sigurisë së ish-Jugosllavisë, përkatësisht Serbisë. Dhe jo pak zëra janë kundër ShBA-së të cilët nxjerrin kokën kurdo që u jepet mundësia për një gjë të tillë, vetëm që të krijojnë efekt politik anti-amerikan.

<sup>15</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>

<sup>16</sup> Po të mos ishte kështu, nga Tribunali i Hagës për luftërat në ish-Jugosllavi nuk do të zhvilloheshin proceset gjyqësore ndaj Fatmir Limës, Haradin Balës e Agim Musliut, si dhe ndaj Ramush Haradinajt, Lahi Brahimaj dhe Idriz Balajt.

<sup>17</sup> Paragrafi 1.2 i nenit 3 të Ligjit nr. 08/L-111 për Arkivat.

<sup>18</sup> Xhevahir Spahiu, *Kohë e krisur*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1992, f. 105.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Belgjika arrin fitore minimale ndaj Kanadasë. Spanja shkatërroi Kosta Rikën

**AR-RAYAN, 23 NËNTOR** - Belgjika e ka filluar me këmbën e mbarë rrugëtimin në Botërorin e Katarit, duke marrë një fitore minimale por të mjaftueshme për sukses. Përfaqësuesja e "Djajve të kuq" triumfoi 1-0 ndaj Kanadasë. Sfidë nisi mirë për kanadezët, të cilët fitojnë penallti në minutën e 11-të, vendim i marrë ky me ndihmën e VAR. Nga pika e bardhë u nis Alphonso Davies, por Courtouis i tha jo, duke i mohuar golin. Kur nuk shënon, e pëson. Kështu ndodhi, pasi pjesa e parë u mbyll me golin e të besuarve të Roberto Martinez. Edhe pse në fushë nuk ishte Lukaku, Batshuayi ia doli të

dërgojë topin në rrjetë. Në pjesën e dytë, belgët administruan në mënyrë perfekte rezultatit dhe tashmë do mendojnë për ndeshjen e radhës ndaj Marokut. Spanja shënoi fitore të thellë 7-0 ndaj Kosta Rikës, duke treguar se do të jetë ndër favoritët për të rrëmbyer trofeun në Katar. Ishte një duel i zgjidhur për 30 minuta lojë nga spanjollët. Në minutën e 11-të, Olmo zhbllkoi sfidën, ndërkohë që dhjetë minuta më pas Asensio realizoi golin e dytë. Ferran Torres thelloi shifrat në minutën e 31-të, por nuk do të ndalej me kaq, pasi në pjesën e dytë do të shënonte golin e dytë



personal. Në të 74-ën, është Gavi që realizon një super gol fluturimthi duke u bërë lojtari më i ri spanjoll që shënon me

kombëtare, vetëm 18-vjeç e 110 ditë. Në Kupën e Borës, është i treti pas Pele dhe Manuel Rosas. Në fundin e kohës së rregullt,

kishte kohë dhe për dy gola të tjerë. Soler dhe Alvaro Morata vulosën rezultatit e thellë 7-0, më i thelli në këtë Kupë Bote.

## Japonia shkakton befasinë e radhës në Botëror, mposhti Gjermaninë



**DOHA, 23 NËNTOR** - Japonia është Kombëtarja e radhës që ka shkakuar befasi në Kampionatin Botëror, pasi e ka mposhtur Gjermaninë me rezultat 1-2. Në pjesën e parë Gjermania e mbylli me epërsi 1-0 me golin e Ilkay Gundogan nga penalltia. Në pjesën e dytë gjermanët patën shumë raste shënimi, por që nuk i shfrytëzuan e në anën tjetër Japonia shënoi në dy prej tri

rasteve që kishte. Për 1-1 u përkujdes Ritsu Doan në minutën e 75-të, kurse Takuma Asano shtatë minuta pa përfunduar ndeshja realizoi për rezultatit final 1-2. Befasinë e parë në këtë kampionat e shkaktoi Arabia Saudite që mposhti Argentinën me rezultat 2-1. Ndërsa në ndeshjen tjetër Kroacia ka barazuar pa gola kundër Marokut në duelin e parë në Katar. Kroatët luajtën

më mirë nuk arriti t'i konkretizoi shanset që krijoi. Vlasiq kishte një shans të artë në minutën e 43-të, ndërkohë që në shtesën e pjesës së parë Luka Modriqi ishte shumë pranë golit, por gjuajtja e tij përfundoi ngjitur me shtyllën. Në pjesën e dytë Maroku ishte afër golit me një goditje të fuqishme nga Hakimi nga distanca. Ky barazim mban të dyja skuadrat në lojë për kualifikim në rrethin tjetër.

## Premtohet spektakël në Superkupë

**PRISHTINË, 23 NËNTOR** - Nga 7 deri më 11 dhjetor e gjithë vëmendja e basketbollit do të jetë në Prishtinë. Super spektakël është premtuar për Superkupën e Kosovës në basketboll. Sot (e mërkurë) është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe Klubit të Sigal Prishtinës për organizimin e Superkupës. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, është shprehur se janë të gatshëm për të organizuar edhe një ngjarje madhore në basketbollin e Kosovës. "Është një prej aktiviteteve kryesore që organizon Federata e Basketbollit të Kosovës. Kjo garë prestigjioze kësaj radhe do të organizohet në

Prishtinë nga Klubi i Sigal Prishtinës në bashkëpunim me stafin e FBK-së, ku besoj se organizimi do të jetë shumë i mirë. Shpresoj, por edhe besoj se do të kemi spektakël sportiv dhe të basketbollit në Prishtinë dhe ajo që e veçon këtë aktivitet është se lejohen edhe shikuesit mysafirë. Pra, palestra në Prishtinë do të jetë e mbushur me tifozë nga e gjithë Kosova dhe normalisht se jemi të lumtur. Synimi është të krijohet një kulturë, kulturë e sportit dhe për të gjithë komunitetin", ka thënë Fetahu. Kryetari i KB Sigal Prishtinës, Blerand Stavileci, ka premtuar spektakël për Superkupë, ndërsa

bardhekaltrit veçohen për organizime. "Fillimisht jam shumë i lumtur që basketbolli po ka shikueshmëri në të gjitha palestrat në Kosovë dhe po ka një super-organizim në të gjitha vendet. Kjo është meritë e klubeve dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe të gjithë të punësuarve në FBK. Është krijuar një kulturë, një kulturë që po i tejkalon kufijtë e sportit dhe normalisht për këtë jemi shumë të lumtur. Interesimi është rritur për basketboll dhe kjo dëshmon për punën e mirë që po bëhet në Federatë dhe në klube. Sa i përket organizimit, besoj se do të jetë diçka me të cilin do të krenohet e gjithë Kosova. Do të



jetë argëtim, spektakël dhe festë, por edhe spektakël i paparë deri më tani", ka deklaruar Stavileci.

Në këtë garë do të marrin pjesë të gjitha klubet e elitës dhe priten sfida interesante.

## Liria eliminon Dritën nga Kupa

**GJILAN, 23 NËNTOR** - Liria e Prizrenit ka shkakuar befasinë e madhe në Kupën e Kosovës. Skuadra e Ligës së Parë ka eliminuar Dritën në 1/16 e

finalës së Kupës, me rezultat 1-2. "Bardhekaltrit" ishin favoritë në këtë ndeshje, por kështu nuk menduan edhe mysafirët, të cilët kreu në fund arritën ta

sigurojnë kalimin tutje. Pjesa e parë në Gjilan kishte përfunduar baras 1-1, ku fillimisht Liria kaloi në epërsi me anë të Tijuezas ('3), ndërsa

Marko Simonovski barazoi me golin e minutës së 32-të. Golin e fitores për prizrenasit e realizoi Ardit Topallaj me kokë në minutën e 89 të ndeshjes.





## Guardiola vazhdon kontratën me Cityn deri 2025

MANCHESTER, 23 NËNTOR - Pep Guardiola do të jetë trajner i Manchester Cityt deri në vitin 2025. Ka qenë vetë klubi anglez ai që ka zyrtarizuar zgjatjen e kontratës me teknikun spanjoll edhe për dy vjet të tjera. Deri më tani Guardiola i ka fituar 11

trofe të rëndësishëm, duke përfshirë katër nga pesë titujt e fundit të Premierligës. Në të gjitha garat ai ka fituar 271 nga 374 ndeshjet që ka drejtuar, pra ka pasur sukses të plotë në 72.4 % të tyre. "Jam shumë i kënaqur që do të qëndroj te Manchester

City edhe për dy vjet të tjera. I falënderoj të gjithë në klub që më besuan. Jam i lumtur dhe ndihem këtu. Kam gjithçka që më nevojitet për ta bërë punën time sa më mirë. Unë e di se kapitulli tjetër i këtij klubi do të jetë i mrekullueshëm për

dekadën e ardhshme. Kjo ka ndodhur gjatë dhjetë vjetëve të fundit dhe do të ndodhë në dhjetë vjetët e ardhshëm, sepse ky klub është shumë i qëndrueshëm. Unë kam besim se mund të arrijmë më shumë së bashku dhe kjo është arsyeja



po unë dua të qëndroj dhe të vazhdoj të luftoj për trofe", ka thënë Guardiola.

## 10 yjet më të vlefshëm të Kupës së Botës

DOHA, 23 NËNTOR - Jude Bellingham ishte tashmë lojtari më i vlefshëm i Kupës së Botës edhe para paraqitjes së tij heroike kur Anglia mposhti Iranin. Mesfushori i Borussia Dortmundit, 19 vjeç, ishte protagonist të hënën. Ai shënoi golin e tij të parë ndërkombëtar me një goditje të përsosur në zonë dhe me kokë. Dhe Bellinghami dominoi lojën me diapazonin e tij të gjerë të pasimeve, kontrollin e topit dhe aftësinë për të goditur. Vlera e tij pa dyshim u rrit si rezultat i asaj paraqitjeje dhe do të vazhdojë të rritet nëse ai do t'i ndihmojë "Tre Luanët" të ecin përpara në Botëror. Por sa kushton i riu dhe kë bën ai në krye të renditjes? Ekspertët e numrave në Observatorin e Futbollit CIES bënë vlerësimet e tyre të fundit në fillim të nëntorit dhe përcaktuan se cilët janë lojtarët kryesorë në Katar 2022, me Erling Haaland që ishte mungesa më e madhe.



### Lista e futbollistëve

1. Jude Bellingham	(Anglia)	175 milionë euro
2. Phil Foden	(Anglia)	172 milionë euro
3. Kylian Mbappe	(Franca)	160 milionë euro
4. Pedri	(Spanja)	137 milionë euro
5. Gavi	(Spanja)	134 milionë euro
6. Jamal Musiala	(Gjermania)	131 milionë euro
7. Rodri	(Spanja)	103 milionë euro
8. Ruben Dias	(Portugalia)	102 milionë euro
9. Bukayo Saka	(Anglia)	95 milionë euro
10. Josko Gvardiol	(Kroacia)	95 milionë euro

## Phoenixi merr kreun në Perëndim, Sacramento vazhdon shkëlqimin

PHOENIX, 23 NËNTOR - Phoenixi mori kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit, pas fitores ndaj Lakersave (115-105), në një sfidë me rivalitet dhe emocione. Bridgesi e Brooks realizuan nga 25 pikë secili në fitoren e Sunsit, duke i bërë të pavlefshme 37 pikët e 21 reboundeve të Davisit për kalifornianët. Ekipi i Philadelphia fitoi me rezultat 115-106 ndaj Brooklynit, me Harrisit që realizoi 24 pikë, ndërkohë që 47 pikë u realizuan



nga lojtarët e stolit, që bëri edhe diferencën. Nikola Jokiçi realizoi 31 pikë e 10 asistime, por që s'mjaftuan për Denverin, që u mund me rezultat 110-108 ndaj Detroitit. Fitorja e shtatë radhazi për Sacramento, që mposhti

me rezultat 113-109 Memphisin, sfidë ku u dalluan De'Aaron Fox me 32 pikë e Barnesi me 26 pikë. Për Memphisin shkëlqeu Ja Morant me 34 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen.

### REZULTATET

Philadelphia - Brooklyn	115-106
Memphis - Sacramento	109-113
Denver - Detroit	108-110
Phoenix - Lakers	115-105

## Baggio: Ende nuk e kam tejkalar humbjen e penaltisë në Botëror

Roberto Baggio ka shikuar prapa në finalen e Botërorit të vitit 1994 të Italisë kundër Brazilit, e cila përfundoi me një top të gjuajtur lartë në qiell. "Kisha mijëra mundësi për ta humbur një penallti, kjo nuk është dashur të

humbet". Legjenda kishte qenë një prej protagonistëve kryesorë që "Azzurri" shkoi në finale në ShBA dhe ishte i fundit që do ta ekzekutonte penalltinë në Pasadena. Me një rrip të rëndë në këmbë për shkak të një

lëndimi dhe pas 120 minutave lojë në një nxehtësi ekstreme, ai goditi, por topi shkoi shumë lart mbi shtyllë. "Nuk do ta harroj kurrë. Ishte një ëndërr fëmijërie që po bëhej realitet dhe pastaj përfundoi në mënyrë më

absurde të mundshme dhe kurrë nuk do ta harroj", ka thënë Baggio për "Il Divin Codino" të SkyTG24. Ai e dinë që tifozët e Italisë e kanë kuptuar për atë gabim dhe e kupton situatën. "Njerëzit gjithmonë kanë treguar

dashuri për mua, e kanë kuptuar vuajtjen time, por unë kërkoj më shumë nga vetja. Kisha mundësi të humbja mijëra penallti në karrierën time, por atë nuk është dashur ta humbas", ka shtuar Baggio.

### SHKURT

#### Përfundon sezoni për Hernandezin

Pas Pogbas, Kantes dhe Benzemas, Franca humbet një tjetër titullar shumë të çmuar. Trembëdhjetë minuta ka zgjatur Botërori për Lucas Hernandez, me mbrojtësin e Bayern Munchenit që u detyrua ta linte fushën mes lotësh. Ajo që stafi mjekësor i druhej më shumë është bërë fakt, Hernandezi ka pësuar një këputje të ligamentit të brendshëm në gjurin e djathtë. Jo vetëm te Franca, ky lajm është përjetuar me ankth edhe në radhët e Bayern Munchenit teksa humbasin shërbimet e një prej titullarëve të padiskutueshëm.

#### Verstappeni bëhet piloti më i paguar në Formula 1

Kampioni i Botës në Formula 1, Max Verstappen, është tashmë piloti me fitimet më të larta në F1. Piloti holandez i skuadrës së Red Bullit, Verstappen, ka kaluar Lewis Hamiltonin në aspektin e fitimeve ekonomike. Sipas raportimeve të fundit, Max Verstappen, me një pagë prej 40 milionë dollarëve dhe bonuse prej 20 milionëve, është piloti më i paguar. Lewis Hamiltoni, në anën tjetër, fiton një total prej 55 milionë dollarëve për vit. Fernando Alonso fiton 30 milionë, Sergio Perez 26, Charles Leclerc 23, kurse Vettel e Ricciardo nga 17 milionë dollarë. Deri këtë vit Hamiltoni ishte piloti me më së shumti fitime në Formula 1.

#### Ronaldo: E dua Unitedin, por ka ardhur koha për një sfidë të re

Cristiano Ronaldo ka reaguar pas largimit nga Manchester Unitedi. Sulmuesi portugez dhe klubi kanë ndërprerë kontratën me marrëveshje të dyanshme. "Pas negociatave me Unitedin, ne ramë dakord që ta ndërpresim kontratën para kohe. Unë e dua Manchester Unitedin dhe i dua tifozët, kjo nuk do të ndryshojë kurrë. Në të njëjtën kohë, ndiej se ka ardhur koha që unë të kërkoj një sfidë të re. I uroj skuadrës suksese në pjesën e dytë të sezonit dhe në të ardhmen", ka thënë Ronaldo, i cili ditë më parë kritikoi drejtimin e Unitedit dhe trajnerin Eric ten Hag.

#### Real po e përcjell Daviesin

Sipas gazetës spanjolle "Sport", Real Madridi është duke përcjellë disa lojtarë nga afër në Botërorin e Katarit. Njëri prej këtyre është superylli eksploziv kanadez, Alphonso Davies, i cili është i preferuar i tyre për kohë të gjatë dhe "Los Blancos" e konsideron pasues të Ferlan Mendysit në pozitën e majtë të fushës. "Los Blancos" nuk janë të sigurt se a duhet t'ia zgjasin kontratën e tanishme mbrojtësit të majtë Mendu, pasi që ai nuk i ka bindur ata me paraqitjet e tij, sidomos në fazën ofensive. Davies (22) konsiderohet si njëri prej mbrojtësve më të mirë të majtë në Evropë dhe ka bërë hapa të mëdhenj në Bayern vitet e fundit. Raporti shton se Davies vlerësohet diku më shumë 70 milionë euro. Për shkak se kontrata e tij me Bayernin skadon më 2025.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



Drejtoria e Arsimit  
14-111/01-252039/22  
Datë: 18.11.2022

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës, shpallë:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

- Drejtor/e në SHFMU "Ismail Qemali", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHFMU "7 Marsi", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHFMU "Dituria", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHFMU "Iliria", Prishtinë;
- Drejtor/e në SHFMU "Shkolla e Gjelbër", Prishtinë;
- Zv. Drejtor/e në SHFMU "Xhemajl Mustafa", Prishtinë;

#### 1. Informata të përgjithshme

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 18.11.2022 deri më datën 02.12.2022;
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

\*Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

#### 2. Kushtet

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
  - Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
  - Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
  - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
  - Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve<sup>1</sup>;
- Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
  - Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;

- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
- Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendës drejtor/eshës.
- Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.<sup>2</sup>

#### 3. Dokumentet e kërkuara

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënua për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor<sup>3</sup>;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike<sup>4</sup>;
- Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës<sup>5</sup>;

#### 4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë

<sup>2</sup> Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional  
<sup>3</sup> Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbyllura apo të hapura kundër tyre.  
<sup>4</sup> Shihni Formularin B/1 për kriteret e pikëzimit të dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale.  
<sup>5</sup> Shihni Formularin I - Model i Deklaratës nën Betim.  
<sup>6</sup> Shihni Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale, por po ashtu Formularin B/1 rreth kriterëve të pikëzimit të dokumenteve.

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucionit edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe kaktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruahtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

#### 5. Detyrat dhe përgjegjësitë për zëvendës drejtorë

Zëvendës drejtori i IEAAP ka përgjegjësi të mbështetëse dhe ndihmojë punën e drejtorit për të siguruar administrimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor, si vijon:

- Përkujdeset dhe përcjell mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ndihmon në krijimin e klimës pozitive në institucionin shkollor;
- Monitoron dhe mentoron mësimdhënësit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Përpunon statistikën e suksesit të nxënësve dhe të dhënat tjera në periudha të caktuara;
- Përgatit raport periodik për mbarëvajtjen e punës së institucionit shkollor;
- Kontrollon ditaret e klasës së paku njëherë në një periudhë mësimore dhe udhëzon mësimdhënësit për mbajtjen e shënimeve në mënyrën e duhur;
- Ndihmon dhe përkrah mekanizmat e institucionit shkollor për menaxhimin e cilësisë së performancës së institucionit;
- Zëvendëson mësimdhënësit në rastet kur mungojnë;

<sup>1</sup> Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzojë dëshmi nga MASHT për këtë.



- 5.8. Pranon, kontrollon dhe sistemon përgatitjen e planeve mësimore të mësimdhënësve;
- 5.9. Zëvendëson dhe përfaqëson drejtorin/eshën e institucionit shkollor sipas nevojës;
- 5.10. Kryen detyra të tjera të caktuara nga drejtori/ esha i/e institucionit shkollor, në pajtim me ligjin.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

#### 6. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planet zhvillimore të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: <https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea>

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

#### 7. Vegëzat elektronike

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë të gjithë kandidatet që t'i lexojnë me kujdes të gjitha shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

**Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020** për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-afetesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

**Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020** - dukë përfshirë Forumaret të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmiave të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokollin e Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: <https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-ia/>

**Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015** Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/>

**Shtojca 4 -Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës**

Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:

[https://prishtinaonline.com/uploads/udhezues\\_per\\_kandidatet\\_per\\_fazen\\_e\\_intervistes\\_per\\_kandidatet\\_ne\\_pozita\\_udheqese\\_te\\_institucioneve\\_edukativo-arsimore\\_docx.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_docx.pdf)

**Shtojca 5 - Dokument informues për vëzhguesit e Komisioneve përzgjedhëse**

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcën bazë e cila do të përdoret nga Komisioni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje me UA151/2020.

Linku:

[https://prishtinaonline.com/uploads/dokument\\_informues\\_per\\_vezhguesit\\_e\\_komisioneve\\_perzgjedhese\\_docx.pdf](https://prishtinaonline.com/uploads/dokument_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve_perzgjedhese_docx.pdf)



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ADULASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1683/1

Dt: 23.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendre e Kompetencës në Malisheve për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi i lirë/ Zëvendësim
QeK	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malisheve	Malisheve	Një mësimdhënës/e për lëndët e matematikës me 20 orë mësimore	Vend i lirë
QeK	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malisheve	Malisheve	Një mësimdhënës/e për lëndën profilin Instalues elektrikë me 20 orë mësimore	Vend i lirë

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

#### Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e publikimit. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Kujtim Krasniqi", në Malisheve.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Farm House B" SH.P.K. me pronar Besmir Hasani, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811377995 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa "Farm House B" D.O.O. Besmir Hasani donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811377995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Farm House B" L.L.C. Besmir Hasani has come to the decision to quit its business: 811377995 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzona Ademi shpall të pavlefshme ID-Kartelen e Kolegjit AAB Prishtinë.

- Edin Pasuli shpall te pavlefshme 4 dëftesa , certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Valentina Gashi shpall te pavlefshme 3 dëftesa, certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Ahmet Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl. I - V shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

